

HEJZA



Lulëzim HAZIRI

KEMI AMBIENT TË KONTAMINUAR LETRAR

Ne dhe teatrot tona

SI MATET MADHËSHTIA ENJË TEATRI!

Teatrot e shoqërive të civilizuar, sidomos teatrot privatë, kanë publikun e vet, të cilët kohën më të madhe të kohës së lirë e kalojnë pikërisht në teatrin e tyre!

Nga Ayu ni HALIMI

Një prej organeve më të rëndësishme të teatrit, pa dyshim që është këshilli drejtues i teatrit! Në statutin e çdo institucioni nacional është i përcaktuar roli dhe përgjegjësia e këtij organi! Sado që nënvizohet se ky këshill është i pavarur, megjithatë, thellë brenda këshillit i fusin duart edhe ministria, por edhe partia! Deri më sot, për këtë kohë të pluralizmit, kemi vërejtur se anëtarë të këshillave drejtues propozohen dhe zgjidhen militantë partiakë, madje edhe përfaqësues nga ministria në këtë organ drejtues propozohen, po ashtu, nëpunës partiakë! Prandaj kemi edhe kaq shumë dështime e probleme nëpër teatrot tona kombëtare, të cilat më tepër ngjajnë në arenë "bodibildingësh" partiakë, se sa në një skenë ku derdhet tërë afiniteti, profesionalizmi, kreativiteti dhe krijimi artistik i punëtorëve të teatrit (regjisori, aktori, muzicienti, kosturnografi, skenografi dhe punëtorët e tierë teknik).

Këshilli dreitues në roli të marionetës

Këshilli drejtues i teatrove publik, si organ i pavarur, duhet të mbikëqyrë punën e teatrit, të aprovojë politikat afatgjata të zhvillimit të teatrit dhe politikën artistike, si dhe të miratojë vendime dhe buxhetin vjetor të teatrit, në bazë të të cilit pastaj, miraton programin artistik vjetor! Natyrishët kompetencë e këtij organi është edhe miratimi vjetor i llogarisë përfundimtare! Pa dyshim, një prej përgjegjësive profesionale të këtij organi është edhe zgjedhja e drejtorit të përgjithshëm si dhe të udhëheqësit artistik! Në këtë organ duhet të propozohen njerëzit më elitar dhe më njohës të teatrit! Së këndejmi, a e di dikush në Maqedoninë e Veriut se cilët janë anëtarët e Këshillit drejtues të Teatrit Shqiptar në Shkup! Kur janë zgjedhur ata, kush i ka zgjedhur, a kanë raportuar ndonjëherë, ndonëse e kanë për obligim që të paktën një herë në vit t'i raportojnë Ministri të Kulturë! A kanë përgjegjësi juridike dhe, mbi të gjitha, kombëtare, këta anëtarë të këshillit drejtues (nëse ekziston dhe nëse funksionon)?

Nën kompetencën e këtij organi drejtues është edhe nisma disiplinore e deri në shkarkim të drejtorit të përgjithshëm! A është marrë dikush në përgjegjësi për këtë gjendje në të cilën gjendet këto tri dekadat e fundit Teatri Shqiptar i Shkupit! A është propozuar ndonjë zgjidhje, a e kanë kushtëzuar funksionimin e tyre me masat që i propozojnë, natyrisht, gjithnjë në të mirë të Teatrit, të aktorëve, të veprimitarisë teatrale kombëtare! Partia në pushtet nuk mund të jetë strehë e përhershme e dështimeve teatrale! Këshilli drejtues duhet të funksionojë nën logjikën përtëj interesave partiakë, që prek ekskluzivisht interesat kombëtare, sepse anëtarët e këshillit drejtues të teatrit duhet të janë personalitetë kombëtare, me autoritet dhe me përgatitje profesionale në fushën e teatrit. Kush më mirë se këta do t'i dinin punët e teatrit? Gjithsesi, jo militantët partiakë dhe as kuadrot politiko-partiakë! Këshilli drejtues lirshëm duhet të konstatojë pér sukseset, pér dështimet, pér keqpërdorimet financiare nga menaxhuesit e teatrit. Ashtu siç ka të drejtë të ngrit iniciativë pér shpërblim të personave që kanë ndikuar në ngritjen artistike dhe në sukseset e teatrit, ashtu duhet ta ketë edhe të drejtën e ndëshkimit, deri në ngritje të iniciativës pér shkarkim të drejtorit të përgjithshëm apo të drejtorit artistik. Duhet të ngritë iniciativë edhe pér anëtarët e trupit teatral që thyejnë disiplinë



në punë, rregulla të teatrit, që refuzojnë respektimin e akteve normative, që sabotojnë punët drejtuese dhe artistike të teatrit! Marrë parasysh këto kompetenca dhe përgjegjësi, marrë parasysh edhe një sërë dështimesh dhe tatëpjetash të Teatrit Shqiptar në Shkup, a mund të ngritet pyetja: kur u mblodh ky këshill drejtues dhe kur solli vendime, qoftë për të mirë qoftë për dështime! A e mori në përgjegjësi ndonjëherë të paktën një drejtues të Teatrit dhe të nxirri në opinion dështimet dhe për pasoje, masat disiplinore kundër drejtuesve të Teatrit! Nëse mbrojtja e kuadrove partiakë qenka rregullativë e një partie, ku ngelë në rastin konkret përgjegjësia kombëtare e këshillit drejtues të një institucionit kombëtar? Teatrot nuk janë "organe" partiakë por janë institucione nationale! Së këndejmi, nuk janë aspak më përgjegjës drejtuesit e teatrove sa janë këshillat drejtues, të cilët, ekskluzivisht janë për realizimin e politikave të teatrit që reflektojnë, ekskluzivisht interesa kombëtare! Fatkeqësish, për momentin, këshilli drejtues i Teatrit Shqiptar në Shkup (që nuk njihet!) është në vazhdën e atyre organeve drejtuese që historikisht kanë pasur rolin e marionetës teatrale! Dhe, ky moment, ia zë të gjitha shtigje drejtoreve që përgjegjësinë ta ndajnë bashkë me këshillin drejtues, apo, për gjithçka, fajin dhe meritën t'ua lënë këshillave drejtues, të cilët, në fakt janë organet më të larta dhe më përgjegjës të një teatri! Është padrejtësi që përgjegjësia të kërkohet vetëm prej dreitorit të emëruar nga këshilli drejtues! Përgjegjësi edhe më të madhe duhet të kenë anëtarët e këshillit drejtues, të cilët, nëse nuk janë të denjë, nuk duhet të pranojnë që të bëhen pjesëtarë të këtij këshilli drejtues. Sukseset e teatrit janë merita të aktorëve dhe të stafit artistik, dështimet e teatrit janë rezultat i pasivitetit dhe neqlizhencë totale të këshillit drejtues!

Morali i heshtjes

Shtresat e elitës kulturore në Maqedoninë e Veriut gjithnjë e më shumë po fishken. Ato duan shpëtim dhe, shpëtimi i tyre është vetëm në themelimin e fondeve si institucione të pavarura (fondi i filmit, fondi i teatrit, fondi i librit apo qendra e librit, qendra e ansambleve, e filarmonisë, e operës etj), kurse ministria të merret ekskluzivisht me politika të larta kulturore, mbi të gjitha, humane. A do të ndodhë kjo venitje, sikur, për shembull, ministria e kulturës të ndante buxhet për "fondin e teatrit" ku do të konkurrilonin të gjithë teatrot dhe

teatër-dashësit! Në botën artistike, pas shkrimitarëve numerikisht më të shumtë janë aktorët! Në botën perëndimore që moti kanë ndryshuar politikat teatrorë! Meqë numri i aktorëve është në rritje e sipër, në rritje e sipër janë edhe teatrot të cilat, kryesisht dëshirojnë të funksionojnë si të pavarura! Në teatrot e sotshëm aktori është më i rëndësishëm se drejtori. Vetëm në Maqedoninë e Veriut teatrot funksionojnë për drejtorin. Madhështia e një teatri këtu matet me numrin e premierave dhe, sa më shumë premiera aq më i suksesshëm është drejtori! Funksioni i teatrit është tkurrur deri në shfaqje të premierës, pas kësaj, nuk është mëkat nëse teatri rri mbyllur për 7-8 muaj në vit! Teatri në fakt është punëtori e aktorit: sa më shumë të punojë aq më shumë do të fitojë! Nuk ka fitim më të madh për aktorin se sa të qenët e tij çdo net në dërrasat e skenës teatrorë ku ai papushuar e kërkon veten, e realizon veten, e gjen përsosmërinë e vet prej aktori të mirëfilltë. Kurse kjo arrihet me përsëritje të shfaqjeve! Përsëritja e shfaqjeve mundëson që çdo aktor të jetë në punë, në detyrë! Teatrot maten me përsëritje të shfaqjeve dhe jo me premiera! Ndaj dhe teatrot duhet të kenë program dhe buxhet për përsëritje të shfaqjeve prej repertorit të krijuar brenda, bie fjala, pesë vjetëve. Premierat pasivizojnë një numër të madh aktorësh, i lënë pa punë, me nga dy-tri vjet e më shumë, ndërsa të papunët duhet të largohen nga organizata! Zaten këtu qëndron edhe morali i heshtjes së një numri shumë të madh të aktorëve, të cilët, tashmë totalisht kanë harruar se ç'do të thosh të aktrosh, të luash në dërrasat e skenës! Heshtin me shpresë se drejtoret partiakë do të kenë mirësinë që t'i angazhojnë në ndonjë premierë, kurse heshtin edhe nga frika se, si të marginalizuar, nëse pak e ngrenë kokën, do të fluturojnë nga puna! Politika kulturore në Maqedoninë e Veriut po përjeton krizen më të madhe që ka përjetuar ndonjëherë! Arti dhe kultura janë partizuar deri në përmasa të banales, ndërsa artbërësit dhe kulturëdashësit nuk kanë asgjë të përbashkët me artin dhe kulturën nacionale. Edhe aktiviteti i tyre por edhe heshtja e tyre është në funksion të jetëgjatësisë së pushtetit politik i cili, këtë kontribut, ua shpërbolen me ndonjë kockë të tharë. Sa mëkat, ë!

A kemi publik teatri

Publiku i çdo teatri përbetet nga shtresa të ndryshme: teatër dashësit që janë në numër shumë të vogël, kjo jo se nuk ka individë që e duan teatrin por, nuk ia dalin në jenë

shumicë për shkak të shtresave të tjera që përbëjnë publikun: familjarët, miqtë e shokët e aktorëve, miqtë, studentët, nxënësit e regjisoreve, administrata që me urdhër të një funksionari detyrohet të "vizatohet" në teatër si dhe funksionarët partiakë që mund të jenë miq të menaxherëve të teatrove, të regjisitorët e të aktorëve. Teatrot e shoqërive të civilizuar, sidomos teatrot privatë, kanë publikun e vet, të cilët kohën më të madhe të kohës së lirë e kalojnë pikërisht në teatrin e tyre! Nëpër ato teatro organizohen debate mbi teatrin ku përfshihet publiku, ligjëratë mbi shkollën të cilën e ndjek teatri i tyre, takime e biseda me artistë në funksion të profesionit të aktrimit, angazhime konkrete për shtimin e publikut, për shtimin e buxhetit të teatrit të tyre duke konsumuar kafe e piye freskuese ekskluzivisht nga kafe-bari i teatrit të tyre.

Fatkeqësisht, teatrot tona kanë ngelur pa publik! Publiku shqiptar që ishte mësuar ta frekuentojë teatrin kombëtar në Tiranë, që tashmë nuk ekziston, e ka të vështirë të ndjek shfaqje nëpër teatrot e improvizuar! Në Kosovë e në Maqedoninë e Veriut, publiku "ka humbur" pikërisht për shkak të "tejngopjes" me premiera të drejtuesve të teatrove, të cilët trishtohen po t'u shkojnë mendja që të organizojnë edhe një 10, 20, 30-50 përsëritje të shfaqjeve! Shfaqjet kanë nisur të jepen vetëm për një publik "ekskluziv", të zgjedhur (!), i përbërë nga administratorë, funksionarë e militantë partiakë, të cilët më me qejf do ta shikonin një tv-film-limonadë se sa një shfaqe teatrale! Madje ky publik fare nuk e njeh regjisoren, fare nuk njeh se ç' shkollë të regjisë zhvillon teatri-shfaqa, nuk i njohin e nuk ua dinë emrat aktorëve; ky publik nuk di asgjë për dramaturgun, ky publik nuk di të t'i numërojë tre dramaturgë kombëtarë, nuk di t'i numërojë dy regjisore shqiptarë të vendit! Ky publik nuk di "t'i gjuajë" gabimet eventuale të regjisitorit, të aktorëve, nuk di ta kapë e ta zërthejë mesazhin e shfaqjes, mesazhin e tekstit, nuk di ta çmojë angazhimin shpirtëror e fizik të aktorëve nuk di të debatojë mbi lojën, mbi konceptet regjisoriale, mbi përshtshmërinë e gardërobës me kohën dhe vendin e ngjarjes që zhvillohet në skenën e teatrit. Nuk di sepse nuk kemi kontribuar në ngritjen e "publikut profesional" të teatrit! Futbolli e ka një publik të tillë! Deri diku (në përmasa të amatorizmit diletantesk) e ka edhe filmi!

Teatri ynë nuk ka publik!
Fatkeqësisht, është punuar shumë mbrapsht që teatrot tona të ngelin pa publik! Publik nuk është ajo turmë njerëzish që mrizojnë nën terrin e sallës së teatrit gjatë shfaqjes! Publik është ai që shkon për të parë shfaqen dhe jo për t'u parë në shfaqe! Publik është ai që shkon edhe një-dy-tri herë të tjera për ta riparë shfaqjen, për t'i kuptuar detajet që e mundojnë ngaqë nuk ia ka dalë t'i kuptojë në përcjelljen e parë apo të dytë të shfaqjes. Publik është ai që të nesërmen e shfaqjes ulet në klubin e artistëve, në kafe-barin e teatrit dhe diskuton mbi shfaqen, e përruron regjisoret, aktorin, kërkon të dijë më shumë për mënyrën e lojës, për ngritjen e zërit vend e pavend nëpër situata të caktuara, për mizanskenën e varfër apo të stërn-garkuar, për muzikën, për dritat... Teatri nuk është red bull që ta bëjë me krah pushtetin! Teatri është oponencë e pushtetit dhe e opozitës. Teatri është pushtet më vete, me "militantë" të vetë që nuk gjenden në asnje pushtet e nëasnje organizim tjeter! Teatrot tanë kanë ngelur pa atë "publikun militant" të vetin, prandaj ngjasojnë në Han të Mahmut Pashës ku hynë e dalin turlifarë mahluku! Sa keq, sa situatë e vajtueshme!

KOLABORACIONIZMI HORIZONTAL

Dashnor KOKONOZI


E kisha dëgjuar këtë shprehje shumë kohë më para se të shkoja në Francë, por pa i kapur mirë thelbin. Tek lexoja një libër për Rezistencën që më tërhoqte shumë, mësova për një numër grash e vajzash franceze (mendohet nga 20.000-40.000) të cilat janë martuar, kanë pasur lidhje apo që edhe thjesht "kanë shkuar nën shtrat me armikun". Ky është kolaboracionizmi horizontal. U quajtën edhe "laviret e boshëve". Pjesa më e madhe e francezëve do ta marrin vesh një gjë të tillë pas Çlirimt, atëherë kur filloj procesi i qethjes së tyre në publik. Në fillim ajo çka ndodhi u cilësua si trajtim i merituar, por këto tridhjetë vjet kam vënë re se si ka evoluar mendimi për një akt të tillë. Sot ky proces analizohet në mënyrë më kritike, gjithnjë e më tepër opinioni nuk pajtohet me ndëshkimin dhe poshtërimin barbar që iu bë atyre.

Kjo e gjitha që thjesht për t'ju paraqitur atmosferën e romanit të shkëlqyer të Julie Héraclès "Ju nuk dini asnjë përmua" (*Vous ne connaissez rien de moi*). Është romani i saj i parë.

Julie thotë se ia ka frysmezuar vetëm një fotografi e Robert Kapës (ajo që është në kopertinën e librit). Është një fotografi rraft e njohur, emblemë e atij procesi dhe rrijhet me emrin "E qethura e Chartres". Në qendër është një grua që sapo e kanë qethur dhe qyteti e ndjek nga pas duke sharë e poshtuar, sa kohë që ajo mban në dorë një fërmijë, fryt i lidhjeve me "gjermanin e saj".

Pas luftës ata u quajtën "fërmijët e boshëve", por kjo është histori tjetër. Robert Kapa, që gjithnjë ndodhej në çastin e duhur në vendin e duhur e ka bërë këtë foto më 16 gusht 1944.

Pak vite më vonë, ai do të ndodhet në çastin e duhur në Indokinë, por në vendin e gabuar, mbi një minë... Por, edhe kjo është një tjetër histori.



Mendime

LETËRSIA, KY MALLKIM I BUKUR

Edhe pse libri nuk është më popullor si filmi, gazeta, TV apo interneti, prapë ai nuk duhet braktisur, a injoruar. Injorimi i librit, është ekuivalenti i një varfërimi shpirtëror të tejskajshëm. Njerëzit do të harronin të thelloheshin në arsyetimet e tyre. Do të ishin më të mjerë

Artur SPANJOLLI

Përse e quaj letërsinë një mallkim? E quaj kështu, sepse ajo e ndjek shkrimtarin në çdo hap, si një obcession, si një fantom, si një fëmijë herë i bindur, herë i pabindur. Herë herë, krejt si një dashnore kapriçoze, që më shumë të merr se sa të jep. Ajo të grabit gjumin, lirinë, independentët tënde. Duhet ta jetosh atë çdo çast si një jetë paralele, me jetën e përditshmë. Ajo është aq e pushtetshme sa gati të alienon, të largon deri edhe nga familjarët, nga lidhjet më të dashura. Të pushton krejt, si një drogë, si një helm i ëmbël. Të dhunon pafajësinë. Të gjallëron ndjesinë e çastit. Nuk e ke më mendjen tek e përditshmja, tek rutina e jetës. Përkundrazi, bëhesh si i huaj, me mendjen veç tek krijimi. Tek fantazmat e saj. Përbindësha, të cilët kur të ngjiten, nuk të shkiten më. Të përndjekin anekënd. Ajo, edhe pse duket e thjeshtë: - ç duhet? mjafton një letër dhe një laps për të shkruar -, ajo është si një zonjë e madhe që ka nevojë përsaltanet. Përkushte. Jo rastësisht, letërsia, ka qenë përherë privilegji i fisnikëve

dhe aristokratëve. Letërsia është kapriçoze dhe ta rrëmbejn shpirtin. Shkrimësia, mbi të gjitha, ka nevojë edhe për orë e orë përfund dedikimi. Orë, leximesh, reflektimesh korrigjimesh. Sidomos puna me tekstin që po merr formë, është një punë plot lodhje, djersë dhe mund. Por kjo lodhje përfund, ky mallkim i tmerrshëm, edhe i fal krijuesit, disa kënaqësi të tjera, të çmuara, të papërshtakuveshme, të papërsëritshme.

Tre janë format e kënaqësise me të cilat letërsia i shpërblyen shkrimtarët.

E para është kënaqësia e mirëfilltë krijuese.

Ajo është e thellë, e pashpërblyeshme, e mrekullueshme, e pashtëkëmbyeshme. Ajo dhuron një gjëzim të brendshëm pa skaj. Eksaltimi shpirtëror, mbushja përbredha, lumturia pa kushte, pa çmim dhe pa të ngjashëm e shkrimtarit kur ndjen se ka shkruar diçka të bukur, është një lumturi, një ngazëllim të cilin nuk ta fal as shpërblimi më i madh ekonomik a material.

E dyta është fitimi i ndonjë honorari nga shitjet e librave. Një kënaqësi

kjo, të cilën shkrimtarët si të mirët dhe ato mesatarët, gati kurrë kanë fatin ta shijojnë. Ndoshta shkrimtarët mediokër kanë më shumë fat në këtë drejtim. Por, ka raste kur edhe krijuesit e mirë, shkrimtarët me vlerë përfund, tek tuk, lindur nën ndriçimin e një yllësie me fat, mundet edhe ta shijojnë atë. Kjo është një nga arsyet përfund shkrimtarët zakonisht janë të trishtë, me humor të prishur, nevrikë dhe shpesh të dëshpëruar. Ndaj, si rrjedhojë, pijancë, vetmitarë, kontradiktorë, të ndarë, me familje të gjymtuara, krejt të çrrëgullt për të mos thënë të shkatërruar nga vuajtjet. Ata, edhe pse janë të ndërgjegjshëm përfund lodhjen përfund, mundohen të gjijnë një ekuilibër të pranueshëm. Për atë që i fal njerëzimit, shkrimtarët i mirë nuk paguhet as edhe një të njëqindën si shpërbirim. Veç se duhet bërë dallimi mes shkrimtarit amator, diletant dhe shkrimtarit, intelektualit, profesionistit.

E treta është admirimi i publikut. Ajo që lexuesi të fal. Suksesi i librit është një nga kënaqësítë estetike më të egra të shkrimtarit. Ne dëshirojmë të lexohemi. Kjo është një dëshirë krejt

natyrale e shkrimtarit. Dëshirë e cila rrallë herë realizohet si ai, shkrimtarët pra, dëshiron vërtetë. Po nuk u lexua, libri vdes, qoftë edhe kryevepë. Leximi, për të, është përtëritje, fitim energjje, limfë jete. Edhe pse libri nuk është më popullor si filmi, gazeta, TV apo interneti, prapë ai nuk duhet braktisur, a injoruar. Injorimi i librit, është ekuivalenti i një varfërimi shpirtëror të tejskajshëm. Njerëzit do të harronin të thelloheshin në arsyetimet e tyre. Do të ishin më të mjerë

Ky fat plot mallkim, i cili e ndjek shkrimtarin përfund 10 vjeçar të tjerë, është edhe udha më sublime e intelektit të tij. Të jesh, a të bëhesh shkrimtar, nuk varet nga shkrimtarët. Ai lind i tillë. Ekzigjencia përfund komunikuar, përfund thënë gjëra të brendshme, është një shtysë natyrale e vetë artistit. Ta thuash mirë, thjeshtë dhe me sinjeritet, ndershmëri intelektuale diçka. Kjo është e rendësishme. Ky është edhe misioni i tij. Vjen apo nuk vjen bashkë me të fati ekonomik a ai i publikut, kjo nuk varet, nuk është në dorë të shkrimtarit.

Interviewer: Lulëzim Haziri, poet

KEMI AMBIENT TË KONTAMINUAR LETRAR

Klubet dhe shoqatat letrare shqiptare janë jo legjitime dhe nuk përfaqësojnë interesat e shkrimtarëve dhe punëtorëve të tjerë kulturorë në këtë vend. Kemi klube dhe shoqata të uzurpuara nga individë, të cilët nuk e njohin fjalën qeverisje e mirë. Një herë zgjidhet kryetar, për të qenë tërë jetën kryetar!

Shkëlzen HALIMI

Lulzim Haziri (1962, Gostivar) është një nga poetët e dalluar, i cili në skenën letrare u paraqit gjatë viteve 8-ta. Përmblehdhen e parë poetike "Kënga lind në vjetri" e botoi në vitin 1989, në SHB "Rilindja" në Prishtinë. Biografia e tij poetike shënon edhe botimin e librave: "Kur dyert hapen me zile" (1995), SHB "Vatra", Shkup, "Dalja nga safari" (2005), SHB "Brezi 9", Tetovë, "Vetmi e varur si numër në portë", përzgjedhje poezish (2015), Logos-A dhe përmblehdjen e fundit poetike, "Testament prej mëndafshi" (2019). Në vitin 2017 iu botua libri me poezi të përkthyera në maqedonisht "Kora lëuboja se troshi kako kreda" (Kur dashuria harxhohet si shkumës), përkthyer nga Lindita Ahmeti, të cilin e botoi shtëpia botuese "Goten" Shkup. Në vitin 2000 Shtëpia botuese "Shkupi" ia botoi librin me shkrime përmuzikën rok "Rokenrolli shqiptar!" dhe në vitin 2010 në SHB "Nositi SH" nga Gostivari botoi librin me kolumna gazetareske "Bardhë e zi". Poëzitë e tij janë të përkthyera anglisht, spanjisht, finlandisht, frëngjisht, rumanisht, kroatisht dhe maqedonisht. Punon si gazetar dhe aktivist për të drejtat e njeriut. Me Hazirin bisedojmë për çështje aktuale që ndërlidhen me skenën letrare shqiptare gjithandje hapësirave shqiptare.

HEJZA: Vepra juaj e fundit, vëllimi poetik "Testament prej mëndafshi", në fakt është një testament poetik dhe jo, do të thoshim, amanet, sepse deri te fjala e fundit kanë për të thurur edhe shumë copa mëndafshi, përkatësisht poezi, që nxjerrin në pah shpirtin poetik të Lulzim Hazirit. Çfarë të dha poezia në këtë udhëtim të deritashëm letrar?

L. HAZIRI: Librin e fundit me poezi "Testament prej mëndafshi" e botova pas një distancë të gjatë kohore, distance që përmua është një rutinë me të cilën kam rënë në ujdi. Nuk jam nga ata të cilët i kënaq publikimi i një libri tëri. Përkundrazi! Përmua shkrimi është një kacafytje me veten. Ndaj edhe shpesh I ik kësaj kacafytjeje. Kam frikë patologjike nga përsëritja dhe kalimi I shkrimit në rutinë, në bukurshkrim. Siç ndryshon çdo gjë rreth tij, ashtu ndryshon edhe autor, ashtu ndryshojnë edhe motivet, ashtu ndryshon edhe stilin, gjuhja dhe gjithë ato saltanatet tjera që e bëjnë një poezi. Miku im, poeti dhe studiuesi Salajdin Salihu e ka pikasur më mire këtë drojë dhe përgjegjësi timen ekstreme ndaj shkrimit, tek thotë: "Poitet mund t'i ndodh që me kalimin e viteve, të bëhet më i përgjegjshëm se sa duhet për shkak të drojës, që nuk është tjetër veçse një pjekuri edhe më e madhe artistike." Dilemën qëllon që ta zbusë paksa ndonjë vlerësim tjetër nga miqtë, siç është ky i poetes Lindita Ahmetit: "Në përmblehdjen "Testament prej mëndafshi" janë dy motive mbi të cilat mbështetet krijimtaria e Lulëzimit: në kënaqësinë për të qenë brenda magjisë poetike dhe në dëshirën për t'u dhënë



amshimin emocioneve të thurura në vargje". Në fund, autor i duhet të ndjej çastin kur poezitë e mbështesin përmuri dhe ato t'i bëjë publike përmes lexuesin. Atëherë i vjen fundi drojës për shkak të përgjegjësisë mizore ndaj gjuhës, frikës se mos kam ndryshuar më shumë se sa duhet. Ky ndryshim mua më duket i natyrshëm, sepse kam ndryshuar edhe unë në hapësirën mes dy botimeve. E ndjej se ka ndryshuar gjuhja ime, ritmi, struktura e vargut, melodja e poeziës etj. E ndjej një autor të ri Brenda meje, i cili është produkt i kohës dhe leximeve. Dilemën se ky ndryshim është i dobishëm apo i dëmshëm, më mirë mund të ma heqin lexuesit. Libri tashmë ka nisur rrugëtimin e vet deri tek ta. S'kam ç'bëj më tepër në këtë magji!

HEJZA: Ambienti ynë letrar, fatkeqësisht që moti është kontaminuar me lloj - lloj mbeturina që dukshëm ia kanë zënë fryshtës së mirëfilltë. Sot kemi më shumë botues se lexues, qarqe të ndryshme "letrare", kemi mafi letrare, kemi epigonizëm, diletantizëm dhe çka jo tjetër? Vlerat e vërteta u përmbyson për shkak se demokracia vazhdon të trajtohet me mjete të anarkisë. Pse ndodhi kjo dhe si ta dekontaminojmë këtë ambient letrar?

L. HAZIRI: E kam vështirë të shtoj diç më tepër nga kjo që numëruat më lartë, aq më tepër që gjithë këto devijime kulturore i kam vërejtur deri sa kam

genë një mandat e gjysmë në Komisionin e Ministrisë së Kulturës për letërsi. Vërejta një matrapazillëk letrar, mashtrime të ulëta që bënin shkrimtarët, amatorizëm që e shisnin si vlerë kombëtare, shkrimtarë të vetë-proklamuar me nivel gjysmë analfabeti të njoftues së gjuhës, reprodukues të një vepre, arrogancë kulturore, që për një refuzim të një kërkese që ua bën, janë në gjendje të të shajnë e kërcenojnë, dhe shumë shërni të tjera, të cilat reprodukohen çdo vjet, duke thithur një buxhet të majmë qindra mijëra eurosh nga arka e shtetit. Kjo përsëritje e këtij ambienti kulturore, e pa kritikuar dhe ndëshkuar nga institucionet shtetërore, e pa debatuar në qarqe kulturore dhe në media, ka krijuar një ambient të kontaminuar letrar, që çdo ditë e më tepër e trashë anarkinë e vlerave letrare. Kjo mafi letrare synon të prezantohet si etalon i vlerave letrare dhe kulturore. Ky organizim perfekt i këtyre matrapazëve kulturore është i dëmshëm përmë kulturën kombëtare dhe sa më parë duhet të ndërmerr masa përmë 'heqjen e taxhisë' nga ana e atyre që "ua mbushin trastë", nga ata që paranë publike të grumbulluar nga taksat e qytetarëve ua shpërndajnë këtyre klaneve të veshura me petka kulturore kombëtare. Teknika e tyre e veprimtë është zhvendosja e vëmendjes nga rrjedha normale e zhvillimeve kulturore. Kakofonia e tyre përmë ndonjë pseudo libër të refuzuar është aq e zhurmshme, sa nuk dëgohen as të arrit-

urat në sferën e kulturës. Kur u digjet bishti, thonë se u dogj fshati! Fola vetëm për ambientin kulturor që financohet nga shteti e që, sipas të dhënave që i kam hasur, mbulon mbi 90 përqind të aktiviteteve kulturore dhe botimeve letrare këtu në Maqedoninë e Veriut. Ky është një problem tjetër i cili duhet hapur! Një formë e këtillë e sigurimit të mjeteve përmë botimeve dhe aktivitetëve letrare e ngulfat garën kulturore dhe jetën publike të librit. Autorët dhe Shtëpitë Botuese vetëmjaftohen me financimin e librave dhe këtu, ose në bodrumet e tyre, përfundojnë librat e botuar. Librat nuk shiten, por falen! Promovimi i rrallë i ndonjërit prej tyre më tepër është akt i lavdërimeve që i bëhen autorit (në të shumtën e rasteve pa mos ia lexuar librin), se sa një akt kulturor ku flitet përmes librin në raport me zhvillimet letrare, përvlerat dhe mangësitë e tij. Nëse nuk diagnostifikohet sa më parë kjo gjendje, nëse nuk mobilizohen dhe organizohen autorët dhe aktivistët kulturore, nëse Ministria e Kulturës nuk i identifikon shkaktarët e kësaj gjendjeje dhe nuk jep kahe të zhvillimeve kulturore, një pseudovlerë e këtillë kulturore do të ngritet në traditë, duke na shndërruar në një provincë kulturore të parëndësishme përmë atë që e quajmë kulturë kombëtare. Në këtë rast, ekzili letrar në Tiranë dhe Prishtinë do të jetë rruga e vetme përmë individualitetet letrare. Të tillë kemi shumë në këtë vend, por, fatkeqësisht, të njëjtë janë të vet izoluar,

ose tē revoltuar!

HEJZA: Natyrisht, mungesa e kritikës e ka bërë të veten dhe, siç thotë një fjalë e urtë, "kur mungon maçoku, minjtë bëjnë dasmë", sot jemi dëshmitarë të një mish - mash të vërtetë në lëmin e botimeve. Sa i kontribuoi kësaj gjendje mungesa e kritikës letrare?

L. HAZIRI: Një ambient i krijuar për të cilin fola më lartë, nuk mund tashë rregullojë kritika letrare. Do të ishte mirë që, së pari të krijohet dhe të strukturohet një ambient për kritikën e mirë-filltë letrare. Universitetet, Institutet i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve, mediat dhe portafilia kulturore, duhet të fillojnë ta nxisin këtë zhanër letrar. Vlerësoj se duke krijuar një ambient që do ta nxiste kritikën letrare, do të jepej një kontribut i vogël në vendosjen e një hierarkie letrare. Të ndahet, siç thoni Ju, shapi nga sheqeri. Sa për vet autorët, të gjithë njëqind e sa librat që çdo vjet financohen nga Ministria e Kulturës, janë "kryevepra". Kontributi i kritikës letrare do të ishte vlerësimi i këtyre botimeve. Kjo do të ndihmonte dhe nxiste edhe lexuesin e ardhshëm, i cili aktualisht mungon si pasojë e rashamonit kulturor. Nuk mundem pa e përmend me këtë rast paraqitjen dhe rolin fisnik që e ushtron profili dhe revista elektronike HEJZA në këtë drejtim. Është një tregim i suksesshëm në jetën kulturore të shqiptarëve që jetojnë në Maqedoninë e Veriut. Tregim që duhet të ndiqet.

HEJZA: Shqiptarët, veç tjerash, për Librin e Ginisit mund të konkurrojnë me numrin e antologjive poetike. Në këto 30 vjetët e fundit, sipas disa të dhënave, gjithandjej ku jetojnë e veprojnë shqiptarët, janë përpiluar e sajuar mbi 800 antologji. Pse kjo dëshirë kaq e zjarrtë për të sajuar antologji "poetike"?

L. HAZIRI: Personalisht më frikëson fjalë Antologji! Edhe më tej jam i mendimit se puna e antologjive nuk duhet t'u lihet autorëve, një personi, aq më tepër nëse ai person është më i ri se 80 vjet dhe nuk e ka dioptrinë e syzeve +6, si pasojë e leximit ndër mote! Nuk mund të përpilojë një antologji të poezisë kombëtare, në gjuhën shqipe, ose në gjuhë të huaja, një shkrimitar! Antologjitet duhet të jenë punë e vazhdueshme e instituteve letarre. Personalisht, më shumë më pëlqejnë antologjitet tematike si p.sh. Antologja e poezeve pér qepén, e të ngjashme. Këtë mund ta bëjë një autor, qoftë ai edhe shkrimitarë. Por, të synosh të përpilosh një antologji kombëtare është përgjegjësi që nuk e mban një shpinë letrare. E mban, por fillon të lakohet!

Nuk kam fjalë tjera të përshtatshme

HEJZA: Në Maqedoninë e Veriut funksionojnë disa klube e shoqata letrare shqiptare. Mbahen shumë orë letrare, ndahen disa të ashtuquajtura "mirën-johje" (gjithnjë në baza interesit). Por, fatkeqësisht, nuk kemi një çmim letrar vjetor, siç ndahen në Prishtinë e Tiranë, një çmim që sado pak do të ishte unifikues dhe nuk do të kishim ambient letrar të përçarë, çfarë aktualisht kemi. Pse nuk kemi forcë për dicka të tillë?

L. HAZIRI: Për mua, klubet dhe shoqatat lettrare shqiptare janë jo legjitime dhe nuk përfaqësojnë interesat e shkrimtarëve dhe punëtorëve të tjerë kulturorë në këtë vend. Kemi klube dhe shoqata të uzurpuara nga individë, të cilët nuk e njohin fjalën qeverisje e mirë. Një herë zgjidhet kryetar, për të qenë tërë jetën kryetar! Edhe mund të jenë, po të mos harxhonin paratë e mia dhe të gjithë tak sapaguesve. Kështu, siç funksionojnë këto shoqata, nuk mund të presim përmrbaitje të reja kulturore, por vetëm



reprodukim dhe përsëritje bajate të aktiviteteve. Tashmë e kanë shndërruar në etalon se si duhet të duket një aktivitet letër.

- Pritja e mysafrirëve nga të gjithë trevat shqiptare;
 - Ora e madhe letrare;
 - Ndarja e çmimeve dhe mirënjojjeve (çmimi pa para, mirënjojje për të gjithë pjesëmarrësit);
 - Darka solemne;
 - Përcillje e mysafrirëve.

- Percjencia e mysurreve.
Mungon debati, mungon rrjetëzimi, mungon promovimi (përveç ai i organizatorit), mungon interkunifikimi me lexuesit dhe shumëcka që do ta avanconte letërsinë.

Ndërsa, sa u përket çmimeve letrare, këtu në Maqedoni nuk e kemi asnjë përbé. Kjo dhe mungesa e tregut, veçse e forcojnë anarkinë e vlerave dhe mundësojnë gëlimin e antivlerave. Në opinion kam dëgjuar idenë që çmimet letrare duhet të jenë obligim i Ministrisë së Kulturës, ashtu siç është në Prishtinë e Tiranë. Kjo mbasë do të ishte hapi i parë për të vlerësuar arritjet e vitit në fusha të ndryshme. Por, një shoqatë e formuar enkas për këtë qëllim, e cila do të kishte përmision ndarjen e çmimeve vjetore për zhanre të ndryshme letrare, e formuar nga emra kompetent dhe me integritet, do të ishte zgjidhja më e mirë për ta organizuar këtë garë dhe vlerësim. Me këtë do t'i eskivohej pezhorativi: shkrimitar qeveritar, çmim qeveritar apo politik. Me një rregullore të mirë dhe me një fond të siguruar nga bizneset dhe Ministria e Kulturës, një akt kaq i madhështor do të mundet.

HEJZA: Ju shpesh merrni pjesë nëpër ngjarje poetike që organizohen në Shqipëri e Kosovë. Por, është një e vërtetë se sa i përket bashkimit shpirtëror, kemi edhe shumë bariera në kokat tona, çka do të thotë se akoma nuk njihemi mes veti ose edhe nuk duam, siç dëshmoi publikisht Rudolf Marku me "antologjinë" e tii. I cili

vlerëson se poezia bashkëkohore shqipe shkruhet vetëm brenda territorit të Shqipërisë. Pse ky refuzim i bashkimit shqiptar?

L. HAZIRI: Ende jemi duke i vuajtun pasojat e proceseve politike dhe shoqërore në hapësirat ku jetojnë shqiptarët. Edhe pse kanë kaluar tri dekada nga rënia e komunizmit në Shqipëri mbi dy dekada nga çlirimini dhe pavarësimi i Kosovës, dhe po kaq nga Marrëveshja e Ohrit, ku shqiptarët

Marresësjë e SHB, ku shqiptarit
filluan të faktorizohen këtu në Maqedoni, politika, që tashmë zhvillohet
brenda ndërtesave qeveritare, ende nuk ka potencën dhe frysni që e paten
riliindësit tanë të organizuar në klube të vogla jashtë territorit shqiptar. Ende
jemi në kërkim të formave të përbash-
këta të bashkëpunimit. Ende jemi në
fazën e dëshmimit të vlerave, të vlerë-
simit apo pjesëmarrjes ad hoc, ose të
bazuar në njohje personale. Pastaj, pak
është punuar në tejkalimin e paragjyki-
meve brenda komunitetit letrar dhe
artistik. Tirana letrare shfaq kompleksin
e superioritetit, që u manifestua
edhe me antologjinë e Markut që e
përmendët më lartë, dhe në forma të
tjera, duke krijuar kështu një ambient tjetër
përshtatshëm vetëm për vete, duke e
anatemuar dhe larguar Kosovën nga
gara me fjalët, "seç e kanë një sintaksë!"
apo duke mos e përfillur dhe duke
injoruar skenën letrare këtu tek ne.
Tirana e mohon edhe letërsinë botërore
të përkthyer "me takatin e vet", por në
kohë të duhur, nga SHB "Rilindja"
vetëm pse disa nga këto libra janë përk-
thyer nga një gjuhë e dytë. Kjo më së
miri u manifestua gjatë vizitës së Ernesto
Sabatos kur të njëjtë iu fsheh fakti që
"Rilindja" ia kish botuar edhe "Tunelin",
edhe "Mbi heronjtë dhe varrezat". Si
kurrë më parë na nevojiten profile letra-
re si ai i Luan Starovës apo Ali Podrimjes
për t'i thyer këto paragjykime dhe për t'u
trasuar forma të bashkimit shpirtëror.

HEJZA: Ju i takoni atij brezi që gjatë viteve 80-ta (për shkak të studimeve) një kohë të gjatë e kaluat në Kosovë. Pikërisht gjatë këtyre viteve kultura shqiptare në Kosovë pati një shpërthim të hovshëm jo vetëm në letërsi, por edhe në artet tjera. Pse ndodhi ky shpërthim i hovshëm dhe si ishtejeta kulturore e atyre viteve, ndonëse në rrethana tejet të vështira për shkak të fillimit të rrënimit të ish Federatës jugosllave (pas ndarjeve të 81-shit)?

L. HAZIRI: Nuk e kam analizuar këtë fenomen dhe shkaqet që sollën këtë shpërthim të hovshëm kulturor. Por, ndjehem i lumtur që e kam përjetuar disa vite këtë kohë. Nga kjo distancë kohore mund të them se shkak për këtë ka qenë Kushtetuta e vitit 1974. Liria që pasoi nga ky akt u shfrytëzua me mend nga punonjësit kulturor shqiptar. U krijuar një ambient i përshtatshëm kulturor, i cili diti të distancohet nga pseudo patriotizmi, që është veprimi i parë që mund ta bëjë një i robëruar, që sapo i hiqen prangat. Kosova e shfrytëzoi me mençuri këtë liri, duke dërguar studentët më të mirë nëpër Universitetet e Evropës, tek mjeshtrit e mëdhenj të mendimit letrar, siç ishin Edgar Moreni, Zhorzh Bataji, Zherar Zheneti dhe shumë emra që s'më kujtohen këtë çast. Për dallim nga studentët e sotshëm, atëbotë shumica e tyre u kthyen në Kosovë dhe vepruan nëpër institucione kulturore. U kthye Ibrahim Rugova, Rexhep Ismaili, Sabri Hamiti dhe një plejadë e shkrimitarëve dhe kritikëve letrarë. Pastaj, rol të rëndësishëm luajti edhe integriteti i redaktorëve dhe drejtuesve të tjerë kulturor të cilët, çuditërisht zgjidheshin për meritat e tyre, e jo afërsinë që mund ta kishin me udhëheqësit e Lidhjes Komuniste të kohës. Në historinë e asaj kohe të Kosovës emrat e Esad Mekulit, Rexhep Qosjes, Anton Pashkut, Ali Aliut, Ali Podrimjes, Azem Shkrelit, Shaip Beqirit, Gani Bobit, Shkelzen Maliqit dhe shumë të tjerëve duhet të janë të shënuara në krye të radhës dhe të janë model i punës së redaktorëve të ardhshëm kulturor. Por, mbi të gjitha, gazetat, revistat letrare dhe SHB "RILINDJA" kishin sensin e kohës. Ua sollën lexuesve shqiptarë kryeveprat e letërsisë botërore, pa pasur barrën e simotrave të tyre në Tiranë.

HEJZA: Gostivari, fatmirësish, ka një jetë dinamike si i përket artit. Ka shkrimtarë, aktorë, piktorë, regjisore, fotograf, ka institucionë kulturore, aktivitete të shumta kulturore, por nuk ka librari. Pse?

L. HAZIRI: Nuk ka librari, sepse njerëzit kohëve të fundit pak lexojnë dhe shitja e librave është biznes i destinuar të punojë me humbje. Ashtu siç i ndodhi librarisë Nobel në Çarshi të Shkupit dhe shumë librarive me fat të njëjtë. Libër-shitia është shndërruar në degë të tregtisë që i duhen subvencione nga ana e shtetit, siç jepen subvencione për bujqësinë, për duhanin apo ndonjë kulturë tjetër bujqësore. Ndërsa, ajo që më mban lidhur për këtë qytet janë individualitetet e theksuara me të cilët bashkëjetoj. Gostivari ka shkrimitarët Shazim Mehmedi e poeten e re Afërdita Xhaferin, ka regjisoren Sulejman Rushitin, fotografin Osman Demirin, dizajnerin Safet Spahiun, piktorët Reshat Ahmetin e Bashkim Mexhitin, ka Teatrin profesionist, ka galerinë KULT dhe Shoqatën e artistëve figurativ DRAUDACUM, dhe "Silindart", Festivalin e teatrove "Othelo", ka Qendrën konservuese dhe tash së fundi edhe Galerinë e arteve. Publiku le të mbetet sfidë e vazhdueshme për drejtuesit e këtyre institucioneve kulturore.

Foto: Rromir Imami

Kalpana Singh-Chitnis, poete dhe regjisore indiano -amerikane

SUKSESI ËSHTË UDHËTIM I VAZHDUESHËM PËR NË STACION...

Kalpana Singh-Chitnis: Jam tepër e lidhur me rrënjet e mia dhe përpinqem të ruaj një ekuilibër shpirtëror midis Indisë dhe Shteteve të Bashkuara. E vizitoj Indinë një herë në disa vjet, gjë që më lejon të ushqej lidhjen me atdheun tim. Në një farë kuptimi, çdo ditë unë ndihem sikur jetoj njëkohësisht në Indi e në SHBA. Thelbi i ekzistencës sime është në Indi, ndërsa prania fizike në Amerikë. E konsideroj veten me fat që jetoj më të mirën e të dy botëve

Intervistoi: IRMA KURTI

Kalpana Singh-Chitnis është një poete, shkrimtare, regjisore dhe aktore indiano-amerikane e vlerësuar me shumë çmime; e nominuar gjithashtu për çmimin Pushcart. Ajo është kryeredaktore e Revistës Life and Legends dhe Redaktore për Përkthimin në Revistën Letrare IHRAF në Nju Jork. Ka botuar pesë libra me poezi dhe veprat e saj janë botuar në revista të rëndësishme letarare si World Literature Today, Columbia Journal, California Quarterly, Indian Literature, Silk Routes Project (Universiteti i Iowa-s), Life in Quarantine (Universiteti Stanford), etj. Është nominuar për "Honor of Yeast Litteraire" nga revista Levure Litterarie në Paris, Francë në vitin 2015. Kalpana Singh-Chitnis është vlerësuar gjithashtu nga zyra e senatores së shtetit të Kalifornisë Mimi Walters, nga ish-kryebashkiaku i Irvinës, Steven Choi si dhe nga Dhoma e Tregtisë për veprat e saj cilësore dhe kontributin që ka dhënë në Komunitet. Librat e saj janë përkthyer në spanjisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, shqip, çekisht, arabisht, nepalisht, etj., si dhe janë botuar në antologji në mbarë botën. Ish-docente e shkencave politike, Kalpana Singh-Chitnis është diplomuar për regji në Akademinë e Filmit në Nju Jork dhe punon si regjisore e pavarur në Hollywood.

Ju jeni poete, shkrimtare dhe regjisore. Cili nga këto pasione ka lindur fillimisht?

Mendoj se dashuria për poezinë ishte brenda meje. Gjatë adoleshencës zbulova pasionin për aktrimin dhe regjinë. Në fillim, drejtova shfaqje skenike dhe aktrova në produksione teatrale në vendin tim të lindjes Bihar dhe në Mumbai. Kam punuar edhe si stiliste në fushën e modës. Pasi erdhë në SHBA, ndoqa Akademinë e Filmit në Nju Jork dhe u diplomova në regji. Megjithatë, në Hollivud, u përqendrova kryesisht në aktrimin në filmat e mi.

Si ndahetjeta juaj mes Indisë, vendit të origjinës dhe Shteteve të Bashkuara?

Jam tepër e lidhur me rrënjet e mia dhe përpinqem të ruaj një ekuilibër shpirtëror midis Indisë dhe Shteteve të Bashkuara. E vizitoj Indinë një herë në disa vjet, gjë që më lejon të ushqej lidhjen me atdheun tim. Në një farë kuptimi, çdo ditë unë ndihem sikur jetoj njëkohësisht në Indi e në SHBA. Thelbi i ekzistencës sime është në Indi, ndërsa prania fizike në Amerikë. E konsideroj veten me fat që jetoj më të mirën e të dy botëve. Megjithatë, ndjej gjithnjë mall për atdheun, pasi pjesa më e madhe familjarëve, të afërmve dhe miqve të mi jetojnë ende në Indi. Më mungon të jem pjesë e bisedave në gjuhën time, të shkruaj në gjuhën amtare, të vishem me rroba tradicionale indiane dhe të festoj evenitet kulturore dhe festat me njerëzit e mi.

Filmi "Pema" është bazuar në poezinë tuaj me të njëjtin titull dhe ka fituar çmime të rëndësishme. E konsideroni



veten një autore të suksesit?

Unë nuk e mas suksesin vetëm duke u bazuar tek vlerësimet dhe çmimet. Ndonëse filmi "Pema", realizuar mbi poezinë time me të njëjtin titull, ka marrë vlerësimin e çmimit të rëndësishme, nuk e konsideroj këtë si përcaktuesin e vetëm të suksesit tim si autore dhe regjizore. Edhe filmi me metrazh të gjatë "Mirupafshim miku im", filmi i shkurtër "Vajza me theks" si dhe përbledhjet e mia poetike janë vlerësuar me çmime. Libri i fundit "Letra dashurie Ukrainës nga Uyava" (River Paw Press), u emërua finalist në "Çmimet Ndërkombëtare për Librin" 2023, prezantuar në Festivalin Amerikan të Librit Gjithashtu, Antologjia "Luledilli: Poezi për Ukrainën mbi Luftën, Rezistencën, Shpresën dhe Paqen", e kuruar dhe redaktuar nga unë, është përzgjedhur në listën e ngushtë për çmimet "National Indie Excellence®", 2023. Ndihem mirënjohej për Çmimin Bihar Rajbhasha, që më është dhënë nga qeveria e Biharit, në Indi për përbledhjen e parë poetike të botuar në Hindi në 1983, Çmimin Global të Ekselencës Rajiv Gandhi për kontributet

e mia në film dhe letërsi, si dhe Bihar Shri. Poezitë nga përbledhja e pestë poetike "Shpirt i zhveshur", janë vlerësuar me Çmimin letrar Naji Naaman 2017 dhe filmi me poezi "Lumi i këngëve" është përfshirë në kapsulat kohore të Kodit Hënë, me misionet e NASA-s në hënë në vitet 2023 dhe 2024. Ndërsa akti i të shkruarit së një poezi, botimi i një libri, bërrja e një filmi dhe marrja e vlerësimeve për to është sigurisht kënaqësi, suksesi i vërtetë qëndron në ndikimin që kanë këto te të tjerët. Aspirata ime si shkrimtare dhe kineaste është të krijoj një lidhje me lexuesit, audiencën dhe veten. Kur librat e mi lexohen, filmat e mi shikohen dhe njerëzit e gjejnë veten tek ta, e konsideroj këtë një sukses. Suksesi përmua është udhëtim i vazhdueshëm pa një stacion mbërritjeje.

Sa orë në ditë i dedikoni të shkruarit?

Nuk kam kohë të paracaktuar për të shkruar. Të shkruarit poezi përmua është një akt spontan. Megjithatë, kohën e lirë ia dedikoj prozës dhe skenarëve të filmit. Ndonjëherë, shkruaj disa ditë rreshit. Por shpesh tërhiqem përm

t'u zbavitur me lexim, gatim, kopshtari, meditim, përkujdesje për kafshën shtëpijake dhe duke kaluar kohë në natyrë. Kjo është e rëndësishme përmua, pasi fitoj një perspektivë të re sa herë që kthehem në tavolinën e punës.

Mund të na thoni diçka më shumë për librin e fundit: "Letra dashurie Ukrainës nga Uyava"?

"Letra dashurie Ukrainës nga Uyava" është një përbledhje me gjashtëdhjetë e tetë poezi të kohës së luftës përdashurinë kushtuar Ukrainës dhe mbrojtësve të saj që luftojnë përlirinë në luftën ruso-ukrainase. Përbledhja është përkthyer gjithashtu në gjuhën ukrainase, me titullin "Любовні листи до України від Уяви", nga Volodymyr Tymchuk, poet, përkthyes dhe nënkolonel në Forcat e Armatosura të Ukrainës. Përkthimi i lejon lexuesve ukrainas të përjetojnë ndjenjat e thella për Ukrainën të përcjella në veprën originale. Një aspekt i rëndësishëm i këtij libri është afati kohor në të cilin u krijua. E gjithë vepra përbërë nga poezitë originale si dhe përkthimi i tyre, u shkrua kryesisht në kohë reale, e përfunduar brenda një harku prej vetëm tetë javësh. Kjo nxjerr në pah urgjencën dhe emocionin e papërpunuar që përshkon poezitë, duke kapur thelbin e konfliktit aktual dhe ndikimin e tij në zemrat e njerëzve. Poezitë në këtë përbledhje shërbijnë si ura; ato synojnë të krijojnë lidhje në zemrat e lexuesve, duke u mundësuar atyre që të simpatizojnë betejat dhe aspiratat e Ukrainës. Duke shfaqur dëshirën përdashuri, paqe dhe liri që rreh në zemrën e Ukrainës, libri kërkon të ofrojë një kuptim më të thellë të gjendjes së vështirë të vendit dhe të ndriçojë shpirtin e qëndrueshëm të tij.

Ka shumë interes për të lexuar këtë libër. Kjo ndodh sepse poezitë kanë të bëjnë me konfliktin aktual të armatosur Rusi-Ukrainë? Çfarë e bën të veçantë këtë vepër?

Në fakt, një nga arsyet e interesit të fortë për "Letra dashurie Ukrainës nga Uyava" është lidhja e tij me konfliktin aktual të armatosur Rusi-Ukrainë. Poezitë japos gjithashtu një këndvështrim të veçantë përdashurinë, duke theksuar rëndësinë e saj gjatë kohës së luftës përvetë ata që përballen me katastrofen e saj.

Çfarë mesazhi dëshironi të përcillni tek lexuesit?

Do të doja t'i inkurajoja lexuesit të marrin një kopje të librit "Letra dashurie Ukrainës nga Uyava", ta lexojnë atë dhe të flasin për të në mënyrë që të ndërgjegjësohen sa më shumë njerëz mbi gjendjen e rëndë të Ukrainës. Për më tepër, i ftoj lexuesit të mbështesin Ukrainën dhe kauzat e saj, kudo që të jenë, qoftë përmes donacioneve, mbrojtjes së të drejtave të Ukrainës, ose angazhimit në aktivitetë që tregojnë solidaritetin tonë me Ukrainën që lufton përmbranjtor lirinë e saj.

KLASËS POLITIKE SHQIPTARE I MUNGON ASHTI PATRIOTIK

Me shembjen e diktaturës dhe krijimin e dy shteteve shqiptare të pavarur, dëshirat dhe shpresat e për të bërë diçka më tepër në këtë drejtim, kanë qenë shumë më të mëdha

Agim BAJRAMI

Krijimi i një strategje të përbashkët përunifikimin e kombit tonë të ndarë në pesë pjesë, ka qenë dhe mbetet një emergjencë e përhershme kombëtare. Që nga viti i largët 1908, kur Kongresi i Manastirit vendosi për njësimin e alfabetit të gjuhës shqipe, ka kaluar një shekull. Mbi tetëdhjetë vjet kanë kaluar edhe kur ministri i Arsimit i shtetit shqiptar nën okupim, Ernest Koliqi, dërgoi me qindra mësues nga Shqipëria në trojet e çliruara nga okupimi serb në Kosovë dhe Maqedoni, përti u mësuar gjuhën tonë të ndritur vocërrakëve të etur përdijetë dritë. Që nga ato kohë duket se dëshira dhe përpjekjet përtat çuar edhe më tej këtë strategji kanë rënë në gjumë letargjik. Rezultatet e pakta të përfutura gjatë kësaj periudhe, më janë përditësuar përditësuar rrethanat e pafavorshme historike. Luftërat e shpeshta, kufijtë dhe politikat e repta shoviniste të fjinjëve tanë si dhe sistemi i egër diktatorial dhe antikombëtar që u vendos në vendin mëmë etj.

Me shembjen e diktaturës dhe krijimin e dy shteteve shqiptare të pavarur, dëshirat dhe shpresat përtë bërë diçka më tepër në këtë drejtim, kanë qenë shumë më të mëdha. Nuk mund të mohohet që në këtë drejtim ku pasur nisma dhe projekte të panumërt nga qeveritë e çdo spektër, të djathta dhe të majta, por që përfat të keq kanë ngelur në vend numëro edhe sot e kësaj dite. Mungesa e vullnetit politik dhe burokracitë bënë që të zgjatej me dekadë projekti i hartimit të abetares së përbashkët shqiptare. Mungesa e po këtij vullneti ka bërë që të mos kemi ende një tekst të njësuar historie, i një libri të përbashkët historie. Kombet e tjerë kanë shekuj që e kanë përfunduar këtë projekt me kaq rëndësi. Të njëtin fat kanë pasur edhe realizimet e projekteve, të përfolur, përdërtim e hekurudhës Durrës - Prizren apo ai i ndërtimit të portit të Shëngjinit (enkas për Kosovën), që nëse do të



bëhen në realitet, do t'i afroonte shqiptarët më shumë me njëri tjeterin.

Por, le të ndalemi tek ideja e integrimit kulturor të trojeve, ku diellit i thonë diell dhe bukës i thonë bukë. Fatkeqësisht, përvëç nismave private të individuve idealistë, unioneve dhe shoqatave jo qeveritare, në të dy anët e kufijve që përpinqen të bëjnë diçka në këtë drejtim (Festat e përbashkëta të plisit ose takimi i grupeve folklorikë të Bjeshkëve të Namuna), edhe pse me mundësi shumë të kufizuar monetare dhe infrastrukturore. Nëse njihesh me buxhetet e caktuara përkëtë fushë nga ministritë përkatëse, konstaton se ato janë kaq të vogla dhe të parëndësishme, sa nuk ja vlen as t'i zësh në gojë. Veti lind pyetja: ngase shkaktohen ky ngërc i frikshëm që na ka kapur përfyt dhe po na mundon prej kaq kohësh dhe kush janë faktorët që i shkaktojnë ato? Duke qenë të udhëhequr nga njërej

aventurier, me të shkuar të dyshimtë dhe pa identitet kombëtar, që atdheun e duan vetëm me fjalë dhe kujtohen të tregohen patriotë vetëm kur shkojnë përkëtë ndjekur në stadium ndonjë ndeshje ndërkombëtare futbolli, përgjigjet dihen ose merren me mend lehtë. Klasës sonë politike i mungon shtylla kurzore ose i ashtuquajturi ashti patriotik. Të mësuar për 60 vjet me të ashtuquajturin internacionalisëm proletar, ku vëllait prej Kosove i thuhej shok, kurse shokut të idealit i thuhej vëlla, as që duhet të na shkojë në mend se mund të presë diçka sado të vogël prej tyre. Pushtetarë të tillë gjëra të kësaj natyre i konsiderojnë kohë të humbur ose apendikse. Në këtë kontekst, jam shumë i bindur që një pjesë shumë e mirë e stafeve që drejtuan politikat kulturore në të dy shtetet tona, dinë shumë pak nga historia janë e përbashkët dhe shumë pak fjalë nga himni ynë kombëtar i

përbashkët.

Arsyeja tjetër eshtë se investimet në këtë fushë, nuk tenderohen dhe për pasojë nuk janë aq eficentë për xhepat e tyre. Duke ndjëre neveri të kujtoj gjumin periodik të Ministritë së Kulturës së Shqipërisë, ku drejtognë prej dekadash militante profanë dhe aspak atdhetarë, mendja më shkon tek Kosova. Eshtë përkëtë ardhur keq që, edhe pse kanë kaluar mbi dy dekada nga krijimi i këtij shteti, ende nuk ekzistonin projekte afatgjata ose afatmesme në këtë fushë. Jam shumë i sigurt se asnjë ministri kulture i porsa ngritur në këtë detyrë, as në mend s'i ka shkuar organizimi i një kuvenç mbarëkombëtar përkështjet e kulturës dhe arteve mbarëkombëtare. Ashtu siç nuk eshtë kujtuar asnjë prej drejtoreve përkates pranë kësaj ministrie të ngrëjë një grup pune për krijimin dhe hartimin e një antologjije letrare mbarëkombëtare, ku Naimi, Fishata, Shkreli, Kadareja, Mekuli dhe Podrimja, të zinin ballin e nderit për t'u lexuar dhe mësuar në çdo shkollë të mesme ose të lartë. Në Festivalin e fëmijëve në Shkodër, vit pas viti, me zor të rrroq syri ndonjë artist të vogël prej Kosove ose prej Maqedonisë së Veriut, edhe pse talentet e vegjël të këtyre vendeve janë kaq të shumtë dhe kaq të etur përkëtë konkurruar në këtë skenë. Nuk po flas këtu përfestivat e munguara apo të cunguara të trupave teatrore shqiptare, ku Prishtina, Tirana dhe Shkupi të ishin nikoqirët e përvëshëm me rotacion të këtij eventi. Ndërsa përsa i përket aktivitetave folklorike, organizimi i tyre ka mbetur ende tek modeli i politizuar i Festivalit të Gjirokastrës, që dikur i kushtohej diktatorit famëskeq shqiptar, Enver Hoxha. Një vend i ndarë me trarë doganash dhe mure eshtë i prirë të hajë vetveter, duke u tkurrur dalëngadalë. Strategjia e bashkimit kombëtar eshtë në vetvete dialektikë zhvillimi dhe progresi. Ata që nuk e kuptojnë mësirë. Ata që e kuptojnë dhe meritojnë mësirë. Ata që e kuptojnë dhe i vënë gurë nën rrota asaj, janë antishqiptarë dhe meritojnë urrejtje...

Përkritikën letrare

TA SHPËTOJMË LETËRSINË!

Çfarë po ndodh me kritikë tonë letrare? Nuk po ndodh asgjë. Në fakt, ajo tash s'ekziston. Pse themi kështu? Sepse, shih ti një fenomen tjetër? Ka me qindra e mijëra botime, ama s'ka asnjë filtri për to.

Fehmi AJVAZI

Secili person që do të bënte një udhëtim në atë që e njohim s'i "territori" kompakt etnik shqiptar, nga Buanocia e deri te udhëkryqia ku ndahet rruga, Gjirokastër - jug dhe Vlorë - perëndim, do ta hetoj një reformim të madh urban. Ky fenomen, nuk fletë përmungesën historike të kushteve sociale dhe të infrastrukturës sonë familjare e biznesore, por fletë për një mungesë totale të vetëdijes përrugullimin e territorit! Sigurisht, tashmë jemi të kapur edhe nga plotë fenomene që, po ashtu janë rezultat i shfaqjes së tyre në mungesë të vetëdijes individuale dhe kolektive. Në fakt, kolektive! Çfarë po dua të them? Shqiptarët, nuk eshtë se nuk kishin vetëdije mbi artin dhe kulturën, gjuhën, letërsinë etj. Madje, kishin goxha vetëdije. Në këtë aspekt, nuk mungonte as kritika letrare. Prania e kritikës letrare, u zhvillua krasa shpërthimët të letërsisë në gjysmën e dytë të shekullit XX. Ishte një letërsi dhe kritikë soc - realiste, ama edhe s'i e këtillë ishte, madje ishte në një

nivel shumë të lartë. Nuk kishe shansin të përviheshë e të hyje në letrat shqipe, pa iu nënshtruar një kritike të rreptë!

Por, kjo eshtë historia e letërsisë dhe e kritikës. Sot, aktuale janë "shterimit" e kameriereve, të takosive, të ndërtimitarëve, të mjeshtëve, të mjekëve, të nxënësve etj. Këto, padysim që janë sot "brenga" reale për secilin nga ne, por janë pasojë e mungesës së vëtedijes. Pse? Miliardat e shqiptarëve, në këto dy dekada të ikura të këtij shekulli, u derdhën në investime, kryesisht të dështuara. Por, jo edhe atje ku "miliardat" do të shumëfishtohen: në art dhe kulturë. Institucionet, kudo në hapësirat shqiptare, u kthyen në argat të fenomeneve deformuese në shqipëri, u bënë krah i kategorive anadolake, dhe po ashtu u rreshtuan t'i ndërtojnë kategoritë shqërore me "udhëzime dhe rregullore të mira", ama jo mbi bazën e formimit edukativ-arsimorë, dhe ngjashëm. Kështu, kanë shteruar dhe po shterojnë edhe kritikët e ndryshëm, veçmas të letërsisë! Në këtë kontekst, kanë shteruar paraprakisht

lexuesit e denjë, meritorët, ata që e mbajnë me oksigjen shpirtin e njeriut dhe të shoqërisë.

Çfarë po ndodh me kritikë tonë letrare? Nuk po ndodh asgjë. Në fakt, ajo tash s'ekziston. Pse themi kështu? Sepse, shih ti një fenomen tjetër? Ka me qindra e mijëra botime, ama s'ka asnjë filtri për to. Nuk ka më shumë se një muaj që isha në librarinë Toena (Prishtinë), dhe në bisedë e sipër me pronarin J.A., doli fjalë se ai zotëronte 7000 tituj librash të botuar të autorëve shqiptar! E, natyrisht, duhet të janë edhe një 7000 mijë të tjerë që s'mbërrijnë te kthinan e bukurë të kësaj librarie prestigjioze.

Pra, edhe ky eshtë fenomen më vete: botimi masiv, pa u përfillur kriteret! Botimi, pa kaluar përbmajtja e tekstit të filtrat e duhur të lektorëve, redaktorëve, recensentëve etj. Pra, pa iu nënshtruar pastaj kritikës letrare! Prandaj, pajtohem plotësish se shkencën e letërsisë nuk e përbëjnë përshtypjet subjektive të lexuesit, shkenca e letërsisë ka nevojë përkritikën letrare, siç ka nevojë gjaku për

oksigjen! E, duke qenë kështu, tash jemi në një situatë kur në mungesë të kritikës së mirëfilltë, quditërisht kemi një invazion autorësh që duan të batojnë - dhe batojnë përditë pa asnjë kriter. Tash, kultura dhe letërsia vdesin dy-tri herë dhe në fund: gjuha! Tash, në hapësirën e gjerë dhe të thellë të aksit që e përmenda më lartë, eshtë në rrezik edhe vet toka janë nga ndërtimet pa fre! Prandaj, aspak nuk eshtë e rastit se në hapësirat e brendshme të këtyre ndërtimeve (materialistë dhe teknikistë të mrekullueshme), vështirë se mund të gjesht një letër dhe një laps për të shënuar një numër telefon! Se jo një libër! Madje nuk gjanië as njerz që banojnë aty. Pra, kritika letrare nuk banon më "në shtëpinë" e shkencës së letërsisë! Dhe, ky realitet, eshtë për t'u sensibilizuar sa më shumë, sepse duhet dalë në ndihmë fjalës së bukur shqipe, pra duhet shpëtuar shkencën e letërsisë nga mungesa e lexuesit, e kritikës, nga injoranca, e sidomos nga mungesa e pranisë së shkëlpimit të dikurshëm të kritikës...

FILMI DHE IMPERIALIZMI KULTUROR

Industria e filmit hollivudian ka krijuar gjithashtu një sistem të veçantë vlerësimesh për përshtatshmérinë e filmave për grupmosha të caktuara. Për një kohë të gjatë, Hollywood-i ka luftuar me censurën dhe vlerësimet e moshës që filmat rregullojnë audiencën për të cilët synohet përbajtja e një filmi të caktuar

Nga Metin IZETI

Edhe në shikim të parë, koncepti "imperializëm kulturor" është shumë i habitshëm. "Tensioni midis këtyre dy fjalëve është mjaft i fortë". Kultura është pjesë e jetës së çdo individu, por edhe e kombit dhe shoqërisë, që gradualisht na formëson. Kultura është ajo që jetojmë nga dita në ditë, ajo që na dallon nga të tjerët dhe ajo që na tregon se si jemi të ngashëm me të tjerët. Kultura e përcakton pjesërisht identitetin tonë. Nga ana tjetër, imperializmi është një fjalë paksa frikësuese. Në këtë kontekst janë të inkluadura edhe konceptet, multikulturalizëm, i cili na mbyll në një pamje të vetë-mjaftueshmërisë dhe transkulturalizëm, i cili mbrojnë ndërmjetësimin dhe shpërndarjen e vlerave simbolike të një kulture në fushën e të tjerave". Me fjalë të tjera, multikulturalizmi në fakt është pranimi i shumë kulturave dhe bashkëjetesa paqësore e tyre, ndërsa transkulturalizmi është përzierja e këtyre kulturave, ndërthura e tyre, ndarja e elementeve të caktuara dhe shkëmbimi. Ndërsa, imperializmi është transkulturalitet i dhunshëm, d.m.th. do të thotë "shkatërrimi i një pjesë të jetës për një tjeter". Në thelb, imperialistët paraqesin një grup njerëzish që nuk pranon se ka grupe të tjera të ngashme dhe të ndryshme, por imponon kulturën, mënyrën e jetesës, traditat, besimet e tij dhe "pushton" të gjitha kulturat e tjera për t'u bërë superiore, ku, kultura që është "e pushtuar" vdes dhe pranon karakteristikat e kulturës dominuese. Imperializmi kulturor mund të jetë një term i ri, por duke parë historinë njerëzore mund të vërehet se qytetërimi njerëzor është përpjekur gjithmonë të shkatërron kultura të tjera dhe të zgjerojë ndikimin e tij. Imperializmi kulturor, në një mënyrë e paraqet dominimin përmes përhapjes së produkteve kulturore.

Aftësia e Hollivudit për të thithur ndikimet e kinematografisë tjetër

Filloi në 1920, kur qeveria amerikane mendonte se shfaqja e filmave amerikanë në ekranet e huaja, do të ndikonte në shitjen e mallrave amerikane. Crothers thotë se, që nga vitet 1970, ata që përdorin termin imperializëm kulturor janë fokusuar kryesisht në SHBA dhe fuqinë e saj për të sunduar botën, jo vetëm në aspektet ekonomike dhe politike të jetës, por edhe në atë kulturore. "Shumë kinema jo amerikane kanë shijuar Amerikën në një mënyrë ose në një tjetër". Ekziston frika se në të ardhmen të gjithë do të jenë një version i kulturës alternative amerikane, nuk do të ketë shumë mënyra se si mund të jetojmë, por vetëm një që ne as nuk do ta dimë kur të ketë pushtuar kulturën tonë dhe ta zëvendësojë atë me të veten. Korporatët amerikane, jo vetëm, por veçanërisht ato audiovizive, si filmat, televizioni dhe muzika, do të mundin industriët dhe kompanitë lokale që nuk mund të përballonin madhësinë e kompanive amerikane dhe, veçanërisht ato të një kulture më të dobët, fjalë përfjalë do të gëlltiteshin dhe shndërroheshin në kopje e vogël e shoqërisë amerikane. Si të thuash, kultura amerikane fillimi përfitoi nga ato më të dobëtat, ku kishte më pak rezistencë dhe ku madhësia e kulturës në fjalë nuk mund të përputhej me tiparet e reja dhe të rëheqëse të kulturës amerikane që vërvshuan sferat e një kulture kaq të vogël.

Duke iu rikthyer kompanive audio-



vizuale dhe pjesës së kulturës amerikane që ne e quajmë Hollywood dhe duke marrë parasysh të dhënat statistikore të filmave të Hollivudit në raport me pjesën tjetër të botës, mund të theksohet se Hollivudi ka gjetur gradualisht por ngadalë tashmë një mënyrë për të depërtuar në pjesën më të madhe të kulturave të botës. "Aftësia e Hollivudit për të thithur ndikimet e kinematografisë tjetër, për t'i inkorporuar ato në sistemin e tij dhe për ta kthyer "të njohurin" në "të panjohur" ose anaselltas, është e njohur botërisht tashmë". Siç shkruan Crothers, që nga viti 2011, shumica e filmave që kanë famë botërore dhe kanë fituar më shumë para janë amerikanë. Ata kishin tema dhe vlera që njihen në mënyrë amerikane, të bëra nga amerikanë apo studio amerikane, të vendosura në një kontekst amerikan ose me aktorë amerikanë. "Nga 50 filmat më të mëdhenj të të gjitha kohësive, 33 ose 66% janë filma amerikanë". Sipas disave, nuk është aq keq të lësh Hollivudit në kinematografi vendase. Pa filmat amerikanë, disa kinema vendase do të dështon, sepse filmat vendas evropiane dhe madje edhe aziatikë nuk janë mjaftueshmë të populuarizuar, as nuk ka mjaftueshmë për të siguruar fitim për aktorët.

Ka një problem tjetër të madh që shfaqet në amerikanizimin e botës, dhe ai është se nuk ka rezistencë se pëse ajo synon anëtarët më të rind të një kulturë të caktuar. Siç ndodh gjithmonë me shfaqjen e teknologjive të reja, të rinjtë dhe të papërvojët, naivët janë gjithmonë të parët që përqafojnë kulturën e tjetrit, veçanërisht nëse ajo është e ndritshme, të rëheqëse, e re, e ndryshme, e gëzuar dhe e pazakontë si ajo e Amerikës. Nga Hollywood, Disney, McDonalds, Facebook, kultura amerikane po pushton dalengadalë botën. Krahas shuarjes së kulturave, tek vetë populli shfaqet edhe një anë tjetër e keqe, të cilët kulturën e re dominuese nuk e shohin si imponim, por vetëm si opzioni tjetër. Nuk përbën kërcënim për ta, erdhë në heshtje dhe paqësi dhe u bë vetëm një opzioni tjetër nga diapazoni nga i cili ata

mund të zgjedhin, dhe është mjaft têrheqës për të têrhequr një pjesë të madhe të njerëzve të kulturës së vjetër që harrojnë vlerat e tyre origjinale, traditat dhe zakonet pa e vënë re fare. Filmat e Hollivudit i detyrojnë (jo)vlerat amerikane kujtdo që nuk shqetësohet t'i rregullojë ato. Teoricienët shpesh debatojnë se si të vlerësojnë, si të përcaktojnë nëse përzierja e kulturave është e dhunshme dhe pushtuese apo thjesht një përmirësim dhe i përshtatshëm për njëren ose të dyja kulturat. Gjëra të tillë nuk mund të dihen paraprakisht me siguri 100% derisa të ndodhin. "Përcaktimi se çfarë saktesisht është apo jo imperializmi kulturor në një botë që po krijon vazhdimisht disa forma hibride të kulturave është e vështirë të thuhet". Jo qdo ndryshim kulturor që ndodh është rezultat i një fuqi perandorake dhe jo qdo përzierje kulturash është rezultat i zhdukjes së njërisë prej tyre.

Amerikanizimi i ideve evropiane

Në epokën e sotme të globalizimit kur gjithçka është menjëherë e disponueshme për këdo, është e vështirë të thuhet nëse ndonjë ndikim amerikan është rezultat i veprimit imperialist apo thjesht një ndërthurje jo agresive e kulturave; ndërsa kultura amerikane përhapet, një kulturë tjetër mund ta refuzojë atë ose ta përqafojë atë. Kjo nuk do të thotë se kjo kulturë tjetër duhet të harrojë apo të hedhë diçka jashtë, ku kultura amerikane konsiderohet të jetë më e fortë. Është e qartë se SHBA si një fuqi e madhe dhe një kulturë dominuese, ka gjetur mënyrën për të qenë prezente në të gjitha anët e botës, por kjo nuk ka pse të jetë një gjë e keqe. Në fund të fundit, kulturat e tjera mund të zgjedhin vetë nëse do të përqafojnë diçka apo jo. I mbetet Hollivudit të përpigjet ta bëjë kulturën e tij më të rëheqëse dhe pikërisht ky është specialiteti që Hollivudi ka zhviluar ndër vite. Suksesi i Hollivudit nuk qëndron në aftësinë për të bërë filma për të gjithë, por në aftësinë për të bindur të gjithë se filmi është bërë vetëm për ta. Është interesante të theksohet se në të kaluarën kishte një lidhje të fortë midis filmave të Hollivudit dhe atyre evropianë, burimi i frysëzimit të Hollivudit ishin pothuajse ekskluzivisht filmat evropianë. Ky ishte një shkëmbim i barabartë sepse filmat evropianë ishin një frysëzim për ata amerikanë, dhe ato ide evropiane u amerikanizuan dhe u ri-importuan në Evropë. Mund të quhet edhe një rrëth i myllur, një përzierje e dy kulturave, por gjithmonë në dobi të Hollivudit. James Bond, për shembull, i ka rrënjet në Britani, por personazhi është eksportuar në SHBA. Një gjë e ngashme po ndodh me Azinë. Filmat amerikanë janë përshtatur me kërkasat kulturore të Azisë dhe si të tillë kopje të përshtatura lëshohen në vend, por gjithashtu frysëzojnë filma të rind në Hollivud. Në këtë mënyrë, Hollivudi është një frysëzim për veten, por si të thuash, me sytë e dikujt tjetër. Idetë që tashmë janë eksportuar ri-importohen dhe përshtaten edhe një herë, për t'u përshtatur edhe një herë dhe për t'u dërguar sërisht në kinematografinë mbarë botën. Në disa raste mund të ndodhë që një zhanër i caktuar të mos jetë i ndikuar nga koncepti amerikan, për shembull, populariteti i filmave të animuar japonez, paraqet një fenomen tjetër të kulturës jo amerikane. Një nga shtyjet më të mëdha që drejtë Hollivudit është ende fitimi. Ne jetojmë në një shoqëri ku Hollivudi na thotë po "Të gjithë mund t'i realizojnë éndrat e tyre, secili mund të ketë atë që dëshiron, të gjithë mund t'i kenë gjithçka", dhe kështu "çdo gjë" bëhet e mirë, pozitive, e dëshirueshme. Ndjenja e mirë krijon varësi dhe ka dëshirë për të parë një film tjetër të mirë, një tjetër film të ri, një tjetër "Aventurë spektakolare" që janë po aq të mira sa prodhimet e Hollivudit, pavarësisht nga cilësia aktuale. Dikur treguesi i një filmi të keq hollivudian ishte se nuk paguante as buxhetin që përdorej për ta bërë atë, tanë filmat e këqij të Hollivudit quhen të këqij kur fitojnë, për shembull, vetëm një të katërtët e asaj që pritej, por



fitimi tremujor eshtë 15 herë buxheti që eshtë shpenzuar për ta bërë film. Globalizimi për të cilin po flasim eshtë bërë praktikisht amerikanizim. Gjithçka që Amerika mendon se eshtë e mirë, rezulton të jetë e mirë. Ushqimi i shpejtë, stil i jetesës, veshjet, hobi, promovimi i lirisë dhe barazisë, si dhe diversiteti dhe filmat që i "ekspoportojnë" të gjitha këto në botë. Duke parë skenën e kinemasë botërore sot, mund të vërejmë se Hollivudi nuk eshtë vetëm një forcë dominuese, por se asnjë kinema tjetër nuk mund të krahasonet me madhësinë e industrisë së filmit të Hollivudit. Në botën e sotme, globalizimi eshtë bërë amerikanizim, Hollivudi prodhon identitetet që dëshiron dhe u shërbën atyre në të gjithë Amerikën dhe botën. Një situatë e tillë nuk u shfaq brenda natës, por eshtë rezultat i më shumë se një shekulli filmash të krijuar me kujdes dhe karakteristikave amerikane të përdorura në mënyrë strategjike. Hollivudi nuk detyroi asgjë përmes filmave, por e bëri atë të disponueshme në të gjithë botën në një mënyrë tërheqëse dhe lozonjare. Një nga tiparet më tërheqëse të Hollivudit eshtë se ai e ka portretizuar Amerikën si një vend plot ngjyra dhe gazmor ku të gjitha mundësitë janë të hapura për absolutisht të gjithë.

Ndikimi i filmit

Sistemi i madh i përdorur nga Hollivudi, sistemi yll, eshtë i vetmi në llojin e tij në botë ku diçka të njashme shohim vetëm në Bollywood, por ku aktorët gjëzojnë statusin e personave të famshëm dhe të adhuruar vetëm në vend. Vetëm Hollivudi i ka kthyer aktorët e tij në të famshëm botërorë, nga ceremonia e ndarjes së çmimeve në një spektakël global dhe nga jeta personale e aktorëve të Hollivudit në një sërë përmbytjesh interesante përpaparacët, shtypin e verdhë dhe fansat. Përfundojmë se Hollivudi ka vepruar në formimin e identitetit në disa nivele. Para së gjithash, Hollividi ndikoi te vetë aktorët dhe aktoret. Ai u bëri të mundur që nëse përpilen mjaftueshmë dhe tregojnë aftësitë e tyre në aktrrim, lavdërimi për atë aktrrim eshtë vetëm një pjesë e vogël e asaj që vijon. Këta aktorë u bënë të famshëm, pak nga pak, në mbarë botën. Jeta e tyre private dhe e biznesit ishte para syve të publikut dhe të gjithë mund t'i gjykonin. Me gjithë këtë vërmendje vjen presioni, ka njëfarë përgjegjësie sepse vetë aktorët, duan apo nuk duan, bëhen model. Hollivudi gjithashtu formëson se kush janë ata në mënyrë që të bëhet pjesë

e identitetit të popujve.

Në një nivel tjetër, Hollivudi ndikon te shikuesit e filmave nëpërmjet aktorëve. Ata krijojnë një imazh të caktuar të asaj që eshtë e njohur, e dëshirueshme, elegante, e guximshme, e lavdërueshme dhe qfarë duhet të jetë një mashkull duke krijuar skenarë dhe personazhe të caktuar që janë më të dëshirueshëm në një kohë të caktuar. Bazuar në atë që sheh, audiencia krijon idetë e veta për atë që eshtë e mirë dhe e keqe, si duhet të jetë dhe qfarë nuk duhet të jetë, qfarë shpërblehet dhe qfarë ndëshkohet, dhe duke i konfirmuar vazhdëmisht ato ide, individet përvetësojnë një identitet.

Në nivelin e tretë, Hollividi ndikon në kinematë e tjera në mbarë botën. Ai merr përsipër temat, idetë, vjetitë e tyre specifike dhe i shndërron në të tijat: mund të themi se i "holivudianizon". Nga ana tjetër, Hollivudi u ofron edhe kineastëvë të tjerë idetë e tyre, filmat e tyre, frymëzim për diçka që ata mund të marrin përsipër dhe të ripunojnë Nivelin i katërt në të cilin vepron Hollivudi eshtë i vetmi indirekt. Bëhet fjalë për një pjesë të populsisë që nuk eshtë në kontakt të drejtëpërdrejtë me Hollivudit dhe filmat, por ky ndikim reflektohet disi tek ata. Këta mund të janë fëmijë ose njerëz që nuk shikojnë filma, por megjithatë përdorin disa fjali të famshme "të përfjetshme" të shqiptuara në ekranin e madh. Këto mund të janë kompani që mbillon ose produkte që humbasin vendin e tyre në treg për shkak të përfaqësimit të keq në filma ose anasjelltas, një shpërthim i kërkesës për diçka pikërisht për shkak të vendosjes së mirë të një produkti në një film. Shumica e autorëve pajtohen se Hollivudi e ktheu globalizimin në amerikanizim. Ne e përkufizojmë imperializmin kulturor si imponim i dhunshëm i një kulture mbi një tjetër me rezultatin e shuarjes së kulturës origjinale mbi të cilën imponohet ngjarja. Në rastin e Hollivudit, ne mund ta zëvendësojmë imponimin e dhunshëm të kulturës me një imponim jo të dhunshëm, por shumë agresiv. Ashtu si reklamimi në filma mund të jetë i fshehtë, kështu mund ta quajmë këtë imperializëm hollividian të fshehtë. Ndikimi i filmave ka vendin e tij pothuajse në çdo aspekt të jetës sot, dhe shumë pak njerëz protestojnë, shumica e të cilëve janë anëtarë me arsim të lartë të komunitetit akademik që studiojnë pikërisht këtë fenomen të kthimit të botës në një "fshat global amerikan" të madh dhe janë ndër të paktët që i kuptojnë pasojet. Brenda se cililit prej katër niveleve përmes

të cilave Hollivudi ndikon tek ne dhe në botë, mund të vërehen pjesë më të vogla që përfshihen brenda atyre niveleve. Konkretnisht, në nivelin e dytë të ndikimit, kur industria e Hollivudit vepron mbi shikuesit, dmth. audiencia mund të shohë pjesë konkrete që lidhen me përcaktimin e identitetit të që individi. Natyrish, janë feja, raca, origjina etnike, gjinia dhe seksualiteti, pjesët që janë më të përfaqësuara. Vlerat që promovon filmi hollividian në nivelin e dytë manifestohen në tre pjesë.

E para eshtë mënyra se si ne e shohim veten dhe anëtarët e fesë, racës, grupit tonë etnik, njerëzve të të njëjtë orientim seksual ose gjinie. Pjesa e dytë eshtë mënyra se si ne e perceptojmë "tjetrin", diçka që eshtë e panjohur për ne, ne krijojmë një imazh të diçkaje për të cilën mund të dimë vetëm përmes filmave dhe pjesa e tretë lidhet me mënyrën si "tjetri" na sheh ne dhe pjesëtarë të një kulture të huaj, një feje që nuk e njeh, vlerat dhe traditat e së cilës nuk i përmblush dhe në bazë të filmave dhe stereotipave të përbajtura krijon një ide të caktuar, ashtu si ne, për "tjetrin". Problemi lind në faktin se qëllimi filletar i Hollivudit ishte dhe mbetet fitimi. Mënyra më e lehtë për të bërë një fitim eshtë duke argëtuar audiencën në mënyrë që Hollivud të shfaqë specialitete grupe njerëzish siç i përshtatet atij në atë moment. Kështu, duke parë disa nga filmat, homoseksualët mund të ndihen si joshës, zezakët si "kafshë" të pashkolluara, muslimanët si gjakderdhës, italianët si maftozët me temperaturë të papritur. Ose siç thotë, Jack Shahen: "Televizioni priret të përfjetësojë katër mite themelore rrëth arabëve: të gjithë ata zotërojnë pasuri përrallore, janë barbar dhe të pakulturuar, janë maniak seksual me mendim skllavëruesh për të bardhët, dhe gjënjë kënaqësi në aktet terroriste". Gratë afro-amerikane, konstaton Bisheta Merrit, shfaqen si figurante në TV e orëve të vona: personi që blen drogën, personi i pastrehë në trotuar, prostitutë në hollet e hoteleve".

Asnjë nga ato imazhe nuk përfaqëson një tipar të mirë, dhe u përdorën masivisht dhe në mënyrë stereotipike për të arritur një komplot argëtues në film. Stereotipe të tilla mund të janë të rrënjosurës thellë tek ata që nuk kanë ndikim në atë grup njerëzish. Shpesh, për shembull, në filmat amerikanë mund të dëgjoje shprehjen ciao bella ("përfshëndetje /mirupashim bukuroshë"), e cila i drejtës është në mënyrë stereotipike çdo femre, sado e papërshtatshme të tingëllonte, ndërsa në realitet vështirë se dikush do të

përshëndeste dikë në rrugë ose në një dyqan me një shprehje të tillë, madje do të tingëllonte e papërshtatshme. Duke vëzhguar këtë nivel të dytë ndikimi, eshtë e qartë se vetë Hollivudi eshtë në pjesën ku ne vëzhgojmë të tjerët, ndaj eshtë e nevojshme të përmendet vetë imazhi i vetvetes që Hollivudi i prezantoi botës. Perceptimi i Amerikës i bazuar vetëm në filma eshtë i shtremberuar dhe jep një pamje mjaft joreale të shoqërisë amerikane. Amerika nuk eshtë gazmore, shumëngjyrëshe, plot mundësi për të gjithë, nuk jep gjithmonë shanse të dyta, të treta dhe të katërtë, nuk eshtë plot me heronj që vijnë në ndihmë, as bukuroshet magjepsëse nuk janë të vetmet që ecin rrugëve. Turma nuk i përket çdo shtëpie ku jetojnë italiane amerikanë dhe as çdo zezak nuk flet me zhargon. Por stereotipe të tilla janë shtytësit e tregimeve në filma dhe kultura në anën tjetër të botës, të cilat kanë akse në filmat e Hollivudit, mësohen të lidhin grupe të caktuara njerëzish me stereotipe të caktuara, qoftë edhe në mënyrë të pandërgjegjishme ose kur eshtë e qartë se eshtë vetëm një stereotip. I gjithë ndikimi që ka Hollivudi nuk lidhet vetëm me filmat. Për shkak të gjithë kulturës së të famshmeve që eshtë zhvilluar për shkak të Hollivudit, eshtë shfaqur një lloj pune krejtësisht e re, fotografë të famshëm, domethënë, papracët. Fillimisht ata u shfaqën në vitet 60 të shekullit të kaluar, dhe sot ka një numër të pabesueshëm të tyre, kryesisht vetëm në Amerikë, për të cilin eshtë përgjegjës vetëm Hollivui dhe eshtë fakt se kjo e ngushton hapësirën e lirisë dhe jetës.

Pushteti i filmit

Industria e filmit hollividian ka krijuar gjithashtu një sistem të veçantë vlerësimesh për përshtatshmërinë e filmave për grupmosha të caktuara. Për një kohë të gjatë, Hollivudi ka luftuar me censurën dhe vlerësimet e moshës që filmat rregullojnë audiencën për të cilën synon përbajtja e një filmi të caktuar. Këto shenja në pjesën tjetër të botës datojnë në vitet '90 të shekullit të kaluar, ndërsa vetëm Britania e Madhe prezantoi shenjat e moshës në mesin e viteve '60, që eshtë vetëm pak vite pas Amerikës dhe sistemit të tyre, i cili mbetet pothuajse i njëjtë edhe sot. Shumë vende i kanë përshtat këto shenja për veten e tyre, por shumica e notave janë të njëjtë me ato të futura nga Amerika, me kufijtë e moshës që janë të ngjashëm. Hollivudi ka ndikuar kështu në fenomenin global të kontrollit të moshës së audiencës për disa filma, jo në të gjithë vendet njëlloj, por në shumicën. Siç u përmend më herët, Hollivudi kishte shumë fuqi për të populuarizuar ose hequr një produkt të caktuar nga tregu, kështu që ka qenë rasti me, drogën, alkoolin, cigaren dhe amoralitetin. Alkooli, cigarja, droga ndryshuan kuptimin që kishin, pra, u bënë simbol i elegancës, maskulinitetit, sfidës, rebelimit, emancipimit të gruas, pushtetit dhe më shumë, dhe markat e tyre ndryshuan në varësi të populuaritetit të filmit. Hollivudi përdori epërsinë e tij mbi këta produkte për të sjellë një ndjenjë të caktuar në filmat e tij në varësi të mënyrës se si këta produkte ishte filmuar, por Hollywood gjithashtu fitoi para në bazë të këtyre produkteve. Reklamimi eshtë promovuesi më i madh i një produkti, i mirë apo i keq, dhe ajo që shfaqet në të gjithë botën vazhdëmisht dhe gjithashtu krijon varësi. Disa teorienë e përshtaujnë Hollivudun si një oktapod që ngadalë por me siguri mbështjell dhe shtërgon krahët rrëth planetit, duke sjellë zakonet, mënyrën e jetesës dhe të folurit e tij dhe duke i dhënë formë botës sipas masës së tij. Eshtë e qartë se Hollivudi ka dëshmuar në pak më shumë se njëqind vjet të ekzistencës së tij se eshtë një forcë globale dhe se ka pushtet mbi një pjesë të madhe të popullsisë. Kjo fuqi mund të diskutohet, mund të tentohet të kufizohet ose të zbutet, por eshtë e sigurt që do të vazhdojë të zgjasë dhe të rritet.

Në shiritin e kohës

IBRAHIM RUGOVA: MUSINE KOKOLARI

Musine Kokolari është njëra nga femrat e rralla që shkroi midis dy luftërave, në periudhën 1912-1945. Për të nuk dirnë shumë tash për tash, pos që më 1940 botoi një libër me tregime e skica me titull "Siç më thotë nënuar plakë". Po shtojmë se pos M. Kokolariit brenda kësaj periudhe vepruan edhe dy femra të tjera: Androniqi Zengo në pikturë dhe në kritikën artistike dhe Elvira Tarro në kritikën letrare, e të dyja ishin korçare. Zengo kishte kryer Akademinë e Artit në Athinë dhe në pikturën e saj ndihet mjaft theksi impresionist i peizazhit. Veprimitaria e këtyre krijueseve flet se në këtë kohë fillon edhe inkudrimi i femrës në kulturën shqiptare, që pas luftës do të jetë edhe më aktiv dhe më i dukshëm. Është mirë të dihet se Kokalari i shkroi tregimet e saj në të folurit çam, pra të krahanës së Çamërisë dhe njëherësh është një ndër shkrimtarët e rrallë shqiptarë që shkroi thjesht në këtë të folme, madje rre qëllim artistik, sepse siç e dimë në historinë e letërsisë shqiptare shumë shkrimtarë tanë kanë shkruar në dialektin e tyre, meqë e ndienin si gjuhë të përgjithshme, e po të vepronte kështu, atëherë M. Kokalari do të shkruante në toskërishten letrare. Po ashtu këtu nuk i marrim ata shkrimtarë që dialektin, në kuadër të gjuhës së veprës dhe të gjuhës letrare, e përdorin për tipizim të personazheve. Për librin e saj, më 1940 në gazeten, nr. 1 të 30 korrikut, poeti ynë i njobur, Lasgush Poradeci, bëri një kritikë mjaft interesante. Vetë përcaktimi i Lasgushit të shkruajë për këtë libër, edhe pse ai shkruante shumë rrallë për ndonjë autor apo libër, e sidomos këtë poet me ndjenjë të hollë për gjuhën poetike dhe me koncept të zhvilluar e të pasur për atë gjuhë. flet se ai në këtë libër e shihte të



realizuar këtë çështje. Madje, konstatimi i tij se autorja e zë jetën në momentin kritik, do të thotë atëherë kur ajo manifestohet në formën më të lartë, po ashtu e vë në rend të parë aftësinë e shkrimit të Kokalarit, prjeta në kulmin e zhvillimit të vet, në të vërtetë të momenteve të saj. Një vlerësim të mirë dhe interesant e iep edhe Maksimil-

ian Lamberg: (Maximilian Lamertz), albanologu i njohur gjerman, më 1948 në librin, Lajpcig 1948, prej nga i morëm këto tregime të Kokalarit. Ai thotë se autorja në dialektin çam na sjell skena popullore në formë të dialogut dhe e çmon gjuhën e talentin e saj.

Në vazhdën e këtyre vlerësimave po

shtojmë se M. Kokalari përmes të folmes së çamërishtes e ngrit të folurit e vet në prozë, të folurit tregimtar dhe përmes këtij të foluri na jep mentalitetin dhe pozitën jetësore të personazheve të atij mesi, e jo përmes ndonjë përshkrimi sociologjik të jetës. Do thënë se personazhe të tregimeve të saj janë gratë, në botën e të cilave hyn përmes rrëfimeve të tyre dialogjike dhe kështu ne kuptojmë problemet jetësore të tyre: konfliktet njerëzore e materiale, realitetin familjar të një kohe, pozitën e gruas, kurtbin, vajin, dasmën, shkurtë, fatin njerëzor në përgjithësi. Pra, autorja na jep një fenomenologji të shpirtit të gruas shqiptare në një kohë të caktuar, që vjen e merr vlerën e artit në të cilin ngrihet e realizohet. Njëherësh po theksojmë se këto tregime janë me interes edhe për gjuhëtarët tanë, madje edhe për elemente për gjuhësinë historike, sepse dialektin që përdor autorja përmban shumë trajta gjuhësore që i ndeshim në veprat e autorëve të njojur arbëresh, si te De Rada, G. Dara, Serembe, Santori e të tjerë, sepse shumë prej tyre ishin me origjinë nga këto vise dhe e kishin marrë gjuhën e atëhershme me vete, madje si fakt se si gjuha ruhet dhe zhvillohet brenda një dialekti dhe brenda një gjuhe në përgjithësi, që duhet të vështrohet si fenomen. Për shembull, trajta të tillë janë golë (gojë), fëmijë (fëmijë), bilë (bijë), ill (yll) etj. Pra, tregimet e Kokalarit e vërtetojnë faktin se edhe dialekti në shkrimin letrar, i përdorur me rjeshtëri, mund të jetë mjaft produktiv krahas me gjuhën letrare brenda së cilës realizohet, ashtu siç është produktiv në zhvillimin e gjallë të gjuhës, në jetën tonë gjuhësore dhe jetësore.

Rilexime

TRI LETRA TË PANJOHURA TË PETRO MARKOS

Në këto letra Petro Marko shtjellon edhe pikëpamjen e tij të drejtë për misionin historik, që ka letërsia në pasqyrimin e ngjarjeve kulturore të jetës shqiptare



Khobid RUSHATI

Duke lexuar librin "Kujtesë" të autores Pandora Dedja (studime, kritikë letrare, mbresa), Sh. B. UEGEN, Tiranë 2006; undala tek pjesa II (Kritikë letrare), dhe më konkretisht te shkrimi: "Tri letra të panjohura të Petro Markos", f. 285). Shkrimi shoqërohet me një parathënie nga shkrimtari Bedri Dedia, Shtator 2002.

PIESĒ NGA PARATHĒNIA

"Bashkëshortja ime Pandora, ka kohë që punon me këtë botim. Ditët e fundit, duke kërkuar në arkivin tonë familjar, ajo gjeti dhe tri letra të panjohura për publikim të Petro Markos, mjeshtrit tonë të madh. Këto letra i janë drejtuar redaksisë së letërsisë për fëmijë pranë Sh. B. "Naim Frashëri", si dhe në veçanti Pandorës në vitin 1969 dhe në vitin 1972. Mendoi se letrat nuk njerqagjojnë thjeshtë

një kureshti letrare. Në këto letra Petro Marko shtjellon edhe pikëpamjen e tij të drejtë përmisionin historik, që ka letërsia në pasqyrimin e ngjarjeve kulmore të jetës shqiptare. Shumë interesante janë mendi- met e Petro Markos mbi letërsinë përfëmijë dhe veçantinë e saj, atje ku ai shprehet se detyra e kësaj letërsie nuk është të merret me deduksione e didaktizëm të thatë, por me zgjidhjen e detyrës themelore, që qëndron para saj "për t'i hapur shtigje imagjinatës" së lexuesve të veciël dbe të ripi."

vegjel dhe të rinj." NGA LETRA E PARË (Shkrimtari Petro Marko falënderon shoqet Dhurata Xoxa, Pandora Dedja; shokët Shefqet Musaraj dhe Mentor Belegun për ndihmën e madhe i kanë dhënë pér përmirësimin e romanit "Halimi"). Në mes të tjerave, P. Marko thotë: "Kam krijuar situata të tilla reale pér atë kohë, duke u ruajtur nga skematizmi dhe nga cdo gjë ireale."

NGA LETRA E DYTË (f. 286) - Letra i drejtoshës Pandora (Dedjes) - Letra flet përvërejtjet e recensentëve për romanin "Fantazma dhe plani tre plus katër". Petro Marko u përgjigjet: "Që të tre shokët, kishin vërejtjet e tyre, të cilat unë i shqyrtova dhe vura re disa prej tyre ishin me vend, ... [...] Unë, duke e rishikuar me kujdes fjalë përfshilës dhe skenë pas skene, duke u ndihmuar nga zbulimet e disa pasaktësive të recensentëve, dhe duke u përpjekur që të jem më i saktë, bëra ndryshimet në pasqë me vend [...] Disa

pikëpyetje që bënte dikush nga recensentët, mu dukën të tepërtë, se letërsia nuk mirret me dedukSIONET e ngjarjeve dhe as gjenezën e aksioneve që zhvillohen gjatë rrugës së zgjedhjes së problemit me të cilin merret një vepër. Po, cilido ka dhe shijet e tij, ka dhe mënyrën e shprehjes dhe të përdorimit të mjeteve të shumta dhe të pakufishme të artit për të goditur atje ku duhet. [...] (shembull: udhëtimi i arapit...) Prura këtë shembull për të treguar, se nuk janë vërejtje të logjikshme për një letrar, ... [...] Nuk vazhdoj, jo Ju shoqë Pandorë, kini për t'ju parë vetë këto pikëpyetje që s'kanë të sosur. Sidoqoftë, cilido ka konceptet e tij për jetë e për art. Disa shkruajnë si unë e disa shkruajnë si ata që kanë bërë recensionet. [...] Për vërejtjet e tjera të recensentëve, unë nuk jam dakord... [...] Sidoqoftë, ju shoqë Pandorë, shikojeni vetë dhe kam besim të plotë se ju do ta shikonin me dashuri për të mirën e veprës. Ju falenderoj; Autori i romanit "Fantazma dhei plani tre plus katër"; Petro Marko Tirane, 26 / IX / 1972.

NË VEND TË PËRFUNDIMIT


Romanet për fëmijë të Petro Markos, veçanërisht "Shpella e piratëve" e sidomos "Fantazma dhe plani 3 + 4" është shoqëruar me një lumë kritikash, të cilat fshehin dashakeqësi, shpesh janë bashkëshoqëruar e metodës së realizmit socialist.

Duke parë me vëmendje dy letrat e panjohura në arkivin familjar të Pandora Dedjes, tekstet e tyre, evidentojnë disa probleme, si: marrëdhënia e shkrimtarit me drejtuesit e redaksisë së Shtëpisë botuese, marrëdhënia e shkrimtarit me recensentët, marrëdhënia e shkrimtarit me identitetin e krijimit të tij, marrëdhënia e shkrimtarit me arsyetimet dhe metodën e realizmit socialist, etj. Të kuptohemi, ky roman nuk është në nivelin e romaneve të tjera. Po çfarë konstatojmë nga letra e parë? Shumë duar janë futur në romanin e tij, shumë "qepje" janë bërë, aq sa Petroja ndjen tjetërsimin e veprës së tij. Por Petroja krahas etikës, me vendosmëri, argument e dinjitet mbrojnë veprën e tij. Nga ana tjetër, konceptet e autorit lidhur me kohën dhe shenjën e veprës, magjinë e krijimit, me ideolet dhe talentin e tij, me vizionet krijuese lidhur me ardhmërinë e kësaj letërsie, sikur janë larg koncepteve arkaike, primitive e të paaftëve drejtues të qarqeve letrare. Ndaj, jo më kot, në këto letra, shprehja përsëritëse e Petros: "... unë nuk jam dakord..." është rezultat i një shkrimtari që ka personalitet, që dha një kontribut të rëndësishëm edhe në zhvillimin e letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj, i dha lartësi të reja. Disa i kuptuan e disa jo vlerat romaneske të këtij shkrimtari të madh. Petroja mbeti i nderuar si njeri e si luftëtar i përgjithshëm.

(Shkodër shtator 2023)

ARSHI PIPA DHE SPROVA E FILOZOFISË INTEGRALE

Përtej gjysmë shekulli censure e trembëdhjetë vjet lamtumire, Arshi Pipa, autor i dantesk i "Librit të burgut", nuk e ka reshtur komunikimin e tij serioz me lexuesin



Nga Ardian MARASHI

Libri më i ri që botahet nga dorëshkrimet e mbetura prej tij, të cilin ai e quante thjesht "Skicë e një konceptimi mbi jetën", është, për shumë arsyë, unik në historinë e lettrave shqipe e madje i veçantë në krejt historinë moderne të mendimit universal. Teksa shkuuan: "Unë mund të heq dorë nga gjithçka, por jo nga mendimi; kjo është e mira ime më e lartë, madje e mira ime absolute", Arshi Pipa është aq i sinqertë e aq i vërtetë, sa asnjë tjetër mendimtar përparrat tij, në mos Sokrati, modeli i tij kurajoz. Mendimtar shqiptar ndodhet në kushtet më të pakonceptueshme për të bërë filozofi. Është në vitin e nëntë të burgut, krejtësisht i sfilitor fizikisht, ndërsa shokët e qelisë i përcojnë imazhin e centaurit mitik, aq shumë burgimi i ka shtazëuar. Mirépo, për mendimtarin, ashtu si dikur moti për oshënarin, edhe burgimi më çnjerëzor mund të shndërrrohet në spiritualitet, përderisa shpirti e mendja rrojnë: "Kanë prangosur trupin tim, por nuk kanë mundur të prangosin mendimin tim. Dhe gjë vërtet e mrekullueshme - kur trupin time kanë bërë pothuaje një kufomë, atëherë mendimi ka fituar lirinë". Në burg, Arshi Pipa nuk ka bibliotekë, por beson se mund të filozofojë nga përvaja, pa referenca të shkruara - njësoj si Sokrati. Për të filozofuar, ai kujton punët e kursit, tezat e antitezat, bisedat e "dialogët" që e ushqyen në vitet e liceut klasik, të universitetit e të jetës së lirë intelektuale - njësoj si Platoni. Dhe, njësoj si stoiku më i thekur, ai filozofon për kuptimin e epërm të jetës shi atëherë kur përreth tij ligësia njerëzore ka kapur kuotat e poshtë-

sisë absolute. Le të kujtojmë, "për atmosferë", situatën e të burgosurve tek "Kanali":

E vdesin fatkëqijt aty te praku,
Vdesin hendeqeve ndër brraka gjaku,
Vdesin nën shrat, ku mshehen përmë vdekë

Vdesin tue pritun bukën, ndër gjiriza
Tue ba nevojën, vdesin posa miza,
Dhe si cofëtina i kallin ndër hendekë.

Në këto kushte, pra Arshi Pipa shkuaran vepër e tij filozofike "Skicë e një konceptimi mbi jetën", në një fletore shkolle të maskuar me portretin e kryearmikut të tij. Në faqet e kësaj fletoreje, pa emër autorit në krye dhe drejtëpërdrejt në italisht - një tjetër maskë kjo, tepër e kushtueshme përmë autorin sqimtar, i cili, edhe pse me origjinë toskë, kishte zgjedhur gjenishen kulturore si gjuhë të veprës së vet letrale - AJO, vepra testament e jetës së tij: "Abbozo di una concezione dell'avito". Vepra plotësitet me punimin "Sul Genio" (Mbi gjenien), i cili i thellon argumentin dhe për të cilin duket qartë se autorit ka reflektouar sistematikisht në vitet e rinisë e të pjkurisë. I gjithë dorëshkrimi është realizuar me shkrim të imët dhe me fare pak korrigjime, çka nënkuon se mendimi ishte krejt i pjkur qysh përparrë se të hidhej në letër dhe se, nga ana tjetër, mungesat e burgut nuk ia lejonin autorit luksin e keqshkronjës dhe të reflektoimit të zgjatur. Në momentin e shkrimit, filozofit të burgosur nën mbikëqyrje të repte të duhet të veprojë shpejt: të hedhë përnjëherë parashtrimin, të sjellë aty përmë argumentet, të bëjë drejtëpërdrejt zërthimin e thellimin e tyre, të cogito-jë rrufeshëm e

të nxjerrë sakaq përfundimet, me një lloj shpejtësie që nuk ngutet. Ai nuk ka kthim prapa, nuk mund të shkaravasë e të rifillojë nga e para, pasi irrethanat e detyrojnë të punojë në kushtet urgjencë, gjatë kohës kur gardianët vigjilojnë gjetju. I duhet të kënaqet me një fletore të hollë shkolle, e cila, përndryshe, ka përparsinë se mund të fshihet shpejt dhe kudo, ama të fshihet me atë zell me të cilin i burgosur di të fshehë hyrjen e tunelit të ngushtë që do ta çojë drejt lirisë. Më tepër se kaq: autorit tonë i duhet ta fshehë veprën e vet me përbetim, edhe pasi të ketë dalë nga burgu, meqenëse "Vëllai i Madh" oruellian përgjoni gjithçka, deri nën lëkurë. Siç dëshmon e motra më e vogël, Nedreti, dorëshkrimi shpëtoi vetëm folë përbetimit të një mikë, ndërkokë që një tjetër dorëshkrim filozofik, "Letra didaktike", që vëllai i përkujdesur ia kushtonte së njëjtës, ndoshës sipas stilit të atit të madh shpirtëror në filozofinë e moralit, stoiku Senekë tek "Letrat Lucilit", humbë pa gjurmë.

Po cila është gjurma që lë Arshi Pipa me distikun "Skicë e një konceptimi mbi jetën" dhe "Mbi gjenien"? Çdokush që e lexon këtë vepër si lexohet një shtjellim filozofik, vëren se argumenti ndërtohet mbi dy parime të ndërlidhur: koherencë dhe ndershëmëria. Arshi Pipa nuk synon të provojë teza specifike e as të demonstrojë stërhollim metode: ai thjesht kérkon, me mjetet e filozofisë dhe përsye praktike, të dijë se cili është përmë njeriu kuptimi i epërm i jetës; dhe, tekso kérkon përmë vete, na bind që ta ndajmë së bashku aventurën e mendimit.

I stërvitur në kritikë filozofie (Vico, Croce, Begson), ai e drejtont logjikën me rreptësinë e një metafizicieni, por vërtetë metafizikën e përjashton nga fusha e vet e kérkimit, me qëllim që mendimi i tij të mos detyrohet të spekulojë, siç vihat re ndër plot filozofë tryze. Në bazë të të gjithë argumentimit, Pipa vendos aksiomën e tij, e cila pohon qartë e prerë se mendimi është gjëjë më e paasgjësueshme dhe pasuria e vëtme e patundshme e qenies njerëzore. Kësijsoj, në kushtet e skajshme që ishin të tijat gjatë burgimit, të menduarit nuk është më vëtëm e thjesht një aktivitet njerëzor, qoftë edhe më i larti, por shndërrohet në akt mbijetese. Për Pipën, të mendosh do të thotë të mbetesh gjallë, do të thotë të justifikosh vëvët në pikëpamjen e njerëzores. Formula karteziane "cogito ergo sum", e cila shpreh njëherësh intuitivin dhe intensitetin e vëtëdijes përmë njerëzoren, duket se merr kuptimin e saj të njëmendët jo me Dekartin, po me Pipën.

Për filozofin shqiptar, njerëzorja ka vëtëm një përcaktim themelor, të menduarit prej tij cili buron gjithçka tjetër: "I vemi ndër të gjitha speciet, njeri, përpinqet ta tejkalojë vëvët, ndërsa speciet e tjerë kanë prirjen vëtëm të ruhen. Kjo i detyrohet faktit që vëtëm njeriu është i pajisur me mendimin". Në vijim, çështja shtrohet në rrafshin e filozofisë së moralit: si dhe përmë çfarë do ta përdorë njeriu mendimin në raport me të cilin ai përcaktohet si specie? Nëse, mandej, pranohet aksiomë se përmë njeriu e mëra gjendet në realizimin e tij të plotë si qenie, pra si qenie rendues - duke kënaqur kështu universalizmin që ka përcaktuar qenësinë e tij brenda species - atëherë pyetja e shtruar më sipër plotësitet në formën: ku duhet të synojë njeriu me mendimin e tij dhe me veprimin e tij moral, më mënyrë që të rrokë universalen, domethënë të realizojë qenësinë e vet, të mëruen e vet?

Jësi përvijohet, pas një demonstrimi bindës, përgjigja e filozofit "Ligji i arsyës praktike do të jetë: "Vepro në interes të njerëzimit!" Kështu, dë të kesh vepruar në interesin tënd të vërtetë, sepse interesit i vërtetë nuk është që të jesh i lumtur (a ekziston, vallë, kjo


fantazi që quhet lumturi?), nuk është që t'i shmanget me çdo çmim vuajtjet, nuk është që ta ruash sa më gjatë jetën: vuajtjet mund të bëjnë më pjellor veprimin tënd, e jeta jote, po të jetë ajo e një derri të kënaqur, çfarë vlerë mund të ketë?" Për të mbërritur te kjo e vërtetë e qenies, autorit ka mobilizuar tërë energjinë dhe arsenalin e vet mendor e kritik, duke i dhënë lexuesit një filozofi origjinal, e cila mbështetet gjërisht në historinë e mendimit filozofik nga pikëpamja e moralitetit. Ambicia e filozofit në këtë kërkim është e dyfishtë: nga njëra anë, ai synon ta shndërrojë filozofinë në një kryeshkencë, e cila shpirtëzon arritet e shkencave dhe të fushave të tjera të veprimtarisë njerëzore, kurse, nga ana tjetër, gjakon ta pajisë njeriu me një filozofi veprimi të denjë përmë njerëzoren. Pipa mbërrin, kështu, në konceptin e filozofisë integrale, e cila heton, kategorizon, përgjithëson dhe potentializon veprimtarinë e të menduarit, që përbën tek njeriu jo vëtëm thelbin e paasgjësueshmë, të qenës së tij, po sidomos mundësinë e pacak përmë vepruar si qenësi renduese e përmë t'u zhvilluar si e tillë.

Ja si e përcakton Pipa këtë tip filozofie, e cila vihet tërësisht në dobi të njerëzores, përmë ta pajisur qenien, siç e presupozon titulli, me një konceptim mbi jetën po aq realist sa edhe të qëndrueshëm: "Filozofia integrale, ashtu si e kuptoj unë, është reflektimi kritik mbi të dhënat e aktivitetit të mendimit të kulluar, si dhe mbi ato të aktiviteteve të tjerë shpirtërore, me qëllim që të japo një konceptim të plotë e harmonik të jetës, me anë të tij cilit njeriu të ekzaltojë vëveten në dritën e vlerave të pavdekshme të shpirtit".

Kjo vepër mund të përfshihet në realizmin e afërt me natyralizmin e disa krijimeve te këtij autori arbëresh, që jep tablo të goditura ngajeta e fshatrave (në këtë rast të Luginës së Savutos dhe fshatrave kalabreze, megjithatë përmendet edhe fshati i Specano Albanezes, fshati i origjinës së dy prej personazheve kryesore, Noçences dhe Mateos). Megjithatë, aty gjemjë edhe ngjyrat e fortë të romantizmit europian në formën e tij më të skajshme që i ekzalton pasionet e fuqishme të dashurisë dhe të urrejtjes, dhe që në Itali gjeti shprehje në romantizmin kalabrez. Mund ta përfshinim romanin e Santorit në atë lloj që do të quhej “roman i masës” dhe që në kohën e tij përfqaqësohet nga romanet e Dymait dhe Sysë në Francë.

Romanet e mëvonshme janë më të ndërlikuara dhe me vlerë më të lartë artistike. Edhe në këtë roman ndihet dëshira e autorit për të komunikuar me një publik sa më te gjërë, dëshirë që nuk iu realizua, siç thuhet me të drejtë në parathënie për shkak të vjetrimit te mesazhit politik të demaskimit te regjimit të Bourbonëve. Mesazhet e rrafshit etik në këtë vepër janë çuditërisht ambivalente (a dënohet më rreptë mosbindja ndaj prindërvë apo mallkimi i nxituar i nënës, dashuria si pasion i verbër apo arbitrariteti i vendosjes së prindërvë përfatësin e fëmijëve?)

Në vepër ka gjithashtu një mesazh shoqëror, paraqitja e varfërisë të fshatrave të jugut të Italisë dhe dukurisë së cubërisë.

Komponenti patriotik shfaqet në pasqyrimin e virthjeve të arbëreshit Mateo dhe në qëndrimin mosmiruates ndaj martesave të përziera (edhe martesa e prindërvë të Rozalbës ishte e përzier; jo më kot arbëreshja Noçenca jepet më largpamëse se i shoqi, ndonëse edhe me gojnë e së bijës flitet për një epërsi mendore të burrit).

Ky roman e pasuron ndjeshëm krijimtarinë e Santorit dhe letërsinë arbëreshe, dhe do të ishte e dëshirueshme të përkthehej në gjuhën shqipe përfatësi i njohur edhe lexuesit shqiptar.

Tregim: Anton PASHKU

KITARA

Zemra ime vallëzon vetëm atëherë kur dëgjon titrimin e telave të kitarës. Vetëm shpatat e zërit të saj mund ta copëtojnë brengën dhe t'ua falin flatrave të harresës. Po, vetëm kitara, kjo kitarë që rri përparrë meje e varur aty në mur, mundet.

Edhe pse tash vrik jam mësuar të luaj me telat e saj, kitara ime lëshon zëra që, duke u ngatërruar ndërmjet vete, krijojnë jone, për mua shumë të hareshme. Vetëm për mua! Them vetëm për mua, sepse tingujt e saj janë shumë të çuditshëm. Nuk mund t'i kuptojë, ose nuk do t'i kuptojë, gjithkush: qajnë kur duhet të gëzohen, gëzohen kur duhet të qajnë. Si tash më kujtohet vaji i vashës, që m'u lut t'i këndoj një këngë. Pranova. Mora kitaren në duar. U ula pranë dritares, duke shkuar në qiellin e natës, i cili, nëpër dritaren time, dukej katërkëndësh me fillim, por pa fund. Pëlqeva telat dhe gishtat e mi zunë të luajnë nëpër to. Tingujt e kitarës përcillnin fjalët e këngës për Hënën e dashruar në një yll që tradhtoi Diellin, i cili, zemëruar pamasë, shkreu që ta shëmtojë përgjithmonë fytyrën e Pabesës.

-Pse t'u mbush mendja ta këndosh këtë këngë?-pyeti ajo dhe sytë ia mbytën bulzat e lotëve që i gufonin pajada.

Rrudha krahët. Rrudha edhe ballin. Nuk dita ç'ti them. Dita, por diçka më lidhi në fyt.

-Po pse, pse po loton?-dëgjova pyetjen mbasi doli prej gojës sime.

-Si...pse?!--tha ajo duke u munduar për t'i ndalë lotët, që i rridhnin nëpër faqe.

-Si, të lutem, si ka mundur Dielli të bëhet aq mizor...

-Mizor?!

-Po, pol-tha ajo—Si ka mundur të bëhet aq mizor ndaj Hënës, e cila për çdo mbrëmje del për ta stolisur lumin tonë me shtyllën e artë të rrezeve të veta?

-Shtylla e artë e Hënës?

-Po e kujt eshtë?

-Fol sa të duash, por ti s'je duke prekur telin e solit?

-Unë?

-Ti, pra. Të Pabesës...-thashë dhe u ndala. Mendimin, që desha t'i them asaj, e përtypa në heshtje.

Më shikonte. Pesha e shikimit të saj, që më kaploj, ishte tepër e rëndë. Ishte e rendë sa s'bëhet.

-Mirë, mirë!-thashë.

Preku telat e kitarës sime. U krijuan tinguj që s'kishin lidhje me njëri tjetrin.

-A di çka,-tha ajo,-ta lëmë Hënën.

-Ta lëmë, nëse na lë.

-Mos u tall!

-Nuk po tallem.

-Atëherë, pra, jipja këngës për sumillën e djersës!

-Për sumillën e djersës, pa të cilën nuk mbin as therra për gardhiqe?

-Po, ke të drejtë.

-S'dua!

-S'dua t'i them asaj kënge, sepse eshtë e dhimbshme.

-Ani që eshtë e dhimbshme, ani.

-Por ti s'e merr vesh!

-Si nuk e marr vesh!-tha ajo.-Vëllaut tim të vogël ia shoh sumillën e djersës sa herë që mundohet ta gënjejë nënën...

-Eh...-thashë unë.

Një e qeshur, për mua fare e pakuptimtë,

shpërtheu në gojën e saj. Ishte aq therrëse dhe e padurueshme, sa mua më hypi gjaku në krye.

Shikova nëpër dritare: m'u duk se një yll kishte zbritur dhe tashti ishte mu përparrë syve të mi. Çova dorën dhe mora hov: desha ta thej kitarën në njëren këmbë të atij ylli. Por, sjellja shkoi kot: ylli ishte larg, atje lart duke hequr valle me shokët e vet.

-Ha, ha, ha!-dëgjohej e qeshura e saj.

Mora kitaren. Drodha një tel. I thashë:

-Për ty, për lëkurën tënde pa asnë pore! Ndali të qeshurit. Më shkoi me ballë të rrullor. Drodha të gjashtë tela e i thashë:

-Për ty, për ty që m'je tingull i pazëshëm!

-Paska tinguj të pazëshëm?

-Ja, paska!

Brofi në këmbë. Bëri një hap dhe u ndal përparrë meje.

-Shiko veten, o i mjerë!-tha ajo.

-O quetar i endrrave, a s'po sheh se je krejt lakuriq!

-Unë?

-Ti, ti...A s'po sheh se ke mbetur lakuriq?...A s'po sheh se kitara të solli rië këtë ditë të zezë?...Hidhe atë kitarë e mos rri kështu lakuriq, se do të bëhesh gazi i botës...

Zonjusha Vulë lëvizi vendit. Megjithatë, shtërvogova kitarën. Kitara u dalldis. Kurse ajo u rrull edhe më shumë. Dikur fluturoi jashtë, duke mbyllur derën me forcë.

Mbeta vetëm unë, kitara dhe tingujt e saj magjikë që përpinqeshin për ta zhavarit ur rrapëllimën e derës së mbyllur...

Shkurt, 1957



Tregim: Kasem TREBESHINA

AJO QË NUK MUND TË KUPTOHET

Ishte një ditë e bukur vere kur dëgjova në shtëpinë e zotnisë ku shërbeja, se atje në anën tonë kishte plasur një kryengritje kundër mbretit. Pastaj u fol se kryengritja u shtyp, kryengritësit u kapën, u burgosën dhe u vranë dhe njërin e varën. Se ata, kryengritësit, kishin vrarë edhe një gjeneral! Mua më dukej çudi. Mbreti nuk ishte më i fortë se prifti i fshatit! Njërin e qëllonin me armë, kurse tjetrit nuk ia kthenin kurrë fjalën...

Dhe iku vera me këto ngjarje... Dhe me të tjera si këto.

Po pastaj?... Ku kishte shkruar vera e vitit të mëparshëm?...

Nuk e kuptoja ku kishin shkuan

ato ditë dhe ç'kishte qenë për mua ajo periudhë e jetës sime. Kaloi vjeshta, dimri... Vera tjetër... Dhe vitet njëri pas tjetrit...

Erdhën ushtri të huaja... Dhe mua m'u duk se u rrita dhe u bëra më i mençur. Vura edhe një pozitë në shoqëri, por nuk guxova më të ktheshë në fshatin tim, në fshatin e vegjelisë sime.

Pse?!

Gjatë luftës kisha kujtar se bota po rikrijohej, se unë i rilindur po shkoja drejt diçkaje të ndritur dhe shumë më të mirë. Por fundi i të gjitha tregoi se çupat më të bukura u martuan me komisarët më të fortë... Sigurisht më të fortë në llafë!...

Një ditë disa shokë të ministrisë ku punoja, fill pas luftës më morën gati me zor për të shkuar në festën e përvjetorit të luftimit të parë kundër gjermanëve. Vajtëm dhe na lanë të fyter sikur të kishim shkuan për të lypur.

Tashti kishin dalë disa njerëz të aftë që dinin ta meremetonin bukur historinë!...Kështu në historinë dhe gjeografinë e ribërë nga ata që kishin qenë më të aftë për këto punë nuk të bënte zemra të ndërmerrje një shëtitje... Dhe unë nuk u ktheva kurrë në fshatin e vegjelisë sime.

Në largësi dhe i pushtuar nga një mall dhe një brengë e fshehtë, u mundova të ktheshë

përsëri atje ku kisha qenë një stinë të vetme... Atje ku i kisha tradhtuar dhe ku më kishin tradhtuar... U mundova në tëndërrimet e mia të ktheshë tek vendi i humbur i stinës së vetme të jetës sime, tek ai vend që nuk ishte më dhe nuk mblodha veç një grumbull kujtimesh për t'i hedhur në letër.

Duket njeriu jeton me të vërtetë vetëm njëzet vjetët e parë, dhe në ata njëzet vjet ka një stinë vere plotësisht të tijë... Dhe unë e pata verën time atëherë me manastirin, me varrezat dhe vajzat që u sollën rrötull meje dhe fluturuan.

Ajo që ikën nuk kthet më dhe ne nuk mund të kemi një stinë tjetër vere.

FABULA URBANE

I.
kam një torbë
që fusja kokën e përdhemë
e nuk i shija retë
se kjo botë ka engjëj
e nuk e dija
se ata dëlinin nga torba ime
nëpër skuta
e stufa të prera
pa dashje e pa pasion,
nuk dija si ti dashuroja...

II.
gjyqet shekullore
për t'u fajësuar unë,
bënин presione
e kallëzime penale
ndërsa unë
ngjalë e përbetuar
iki liqeve
nuk ka varkë që nuk
i përbetohem
se vëtmia nuk pranon gjyqe
e dua lirinë aty ku s'je ti më!

III.
dritare
që ushqehen me ushunjëza
tavane të ngopura me britma
dyer të fashitura gjarpërinjsh
e murete shembura frymonin,
thjesht
binte shi,
lagej shpirti
në dhomën ku jetoja!

IV.
krahu u thye
prej pambukut
panxharsheqerit
gjersa rigonte ujë i verdhë
nga gjirizet që shpërlanin
fytyrën e vjeshtës
shekullore,
PIK, me pykë
mu bë krahu i thyer
me allçinë e ngjizur
nga gjethnajat

V.
tallaze deti mbi floknajë
spira xhami qenë dromcuar
kuajt ishin ende të qetë
me hingëllimën
si kurorë lulesh
nisur përpjetë,
liri e dendur
si floknaja shtëllungë
me një pajton duke
lundruar mbi det.

VI.
Në disa rezervuare indiane
(jo tek te gjithë)
ua kishin prerë
gjuhën shqiponjave,
lumenjtë që kalonin
nëpër këto rezervuare
qepin lëkurën
e kuqe të indianëve,
meqë gjuha e shqiponjave
nuk sokëllinte, beteja
nuk i zmbapsi asnjëherë,
por, atë natë
vdiq zemëruani
bashkë me
kokëujkun,
ranë dëshmorë
në betejën e quajtur
beteja e shqiponjave
nëpër mjegulla.

VII.
atdhe
ora e prishur
në vakt të sosur
një predhë me lule
ra mbi
gjelin këndes
buzëqeshë me peshqesh
ngrefosej
deri në mbërëmje
gjersa ja prenë kokën,
agimet vdiqën
bashkë me flamujt!

VIII.
kur flasin mushkonjat
mpikset gjaku
e asfalti që shtrihej
mbi ëndrrën
e qepur tog
gjithherë kërmijtë
krijonin karvanë shkretëtirash

IX.
zebrat laramane
pollën
në kohën kur yjet
sinkronin
në rrugën e qumështit
e rruga gjerë
te kafazet e hekurga
përjashtoj bylbylat laraman
obobo, çfarë xhungle
në autobusët urbane.

X.
e gërdallë ishte mushka
as fijen e kreshtës
se mbante më si pasqyrë
imazh e vitrazh
i dendur e i kotë,
dihatej në grahmën
fundit
me kërpeshinduke cofë.

XI.
kasolle e mbushur me barishte
xixëllonjë e fikur në kuzhinë
shkëlgente thika
në kavanozin e harruar
jetë e mbushur përplot vetmi
si drenushë e humbur maleve!

XII.
kishte vdekur e ëmbla
gjithë të kripësuar
e mbanin veten e tyre
urithet,
breshkat,
bletët,
gjirafat,
nuk më lëkundi fare
nëndhesja, jetëgjatësia,
punëtorja e gjatësia,
por e keqja ishte
se të gjithë ishin
nëpërkëmbur
nga analistët politikë në TV

XIII.
piktura ishte pikturuar
nga bojërat e harabelave
lehtësisht
si pendël
shkelte këmba e elefantit,
por të gjitha thanë
se është këmba e diktatorit!

XIV.
zanat e malit
qenë të trishtuara,
njësojë kur turren
kamerat para
ndërtesave të paligjshme
që kërkojnë deklarata
të qarta, por me prapavijë,
pronarët ishin zgjuar
lugetë!
zanat e malit i kishin përpjek

XV.
me forcat e fundit
lepuri ja kaloj
me shpejtësi breshkës,
më duket se ndodhi e kundërtë,
legjendat thanë
atë që nuk e besuan,
mos vallë
ka forcë më të madhe
sesa ta tejkalosh vetveten!

XVI.
harmonia
ju hidhërua
disharmonisë
dhe në një rast e pyeti
si është e mundur
që dhelpra dinakë gjithnjë të fiton?
erdhe kaosi me shpejtësi,
i shkeli të gjithë me BMW.

XVII.
doemos fytyrat
të lahen me qerpiq
aty ku grerëzat
nuk gumëzhinë
me grimasa,
ka supozime
se fytyra deformohet,
por për elasticitet
i lyejmë me bojërat origjinale
dhe nuk duket gjë fare më pastaj,
njëjtë ecim rrugëve ende
s'ka drita, nuk na duket fytyra më!

XVIII.
në gjetë të rrushit
hardhuca bashkë me hardhinë
bënin koalicionë partiake
ndjesë pastë
i gjithë faktori
i jashtëm dhe i brendshëm
ne u fotografuam
mirë kanë dalë fotot,
tjetra nuk është me rëndësi!

XIX.
strofull minjsh
përkundin djepin e lashtë
nuk e do dora
që të prek më kullat
na i shtrembëruan edhe plisat
njësojë kur hakun e hëngrem
në mexhe të fqinjët
e tanë as minjtë nuk na hajn më!

XX.
ti je vëtmia ime
që dergjem ende,
dashuri e paarritur,
flutur, që jetoje mbi
mëngën time
kur të përkëdhelja,
gjithnjë na ngrohte dielli
por tullat dhe hekurat
e ndërtimëve të paligjshme
na ndanë përgjithmonë!

Bob Dylan

BALADA E DONALD WHITE

(Historia e trishtë e një vrasësi)

Emri im është Donald White siç e shihni, para jush po qëndroj, i dënuar për vrasje, dhe së shpejti koka ime në duar të xhelatit do të jetë.

Kur të kemi dhënë shpirt atje lart hëna butësishet do të ndriçojë, këto janë fjalët e fundit që do t'i dëgjoni nga goja ime.

Nga shtëpia ime në Kansas u largova kur qeshë fare riosh për të zbankuar në veriperëndim, në Seatël të Uashingtonit.

Bëra gjithë ato milje udhë por kurrë s'gjeta një mik për të qenë, me gjithëse shumë njerëz takova

ata në shoqërinë e tyre s'më pranuan.

Sikur të mund të arsimoheshë në fillimet e mia, tani do të isha doktor i njohur apo mjeshtër i ndonjë arti.

Por ç'ë do që duart i përdora për vjedhje në rininë time, s'kalojë shumë, ata në birucë më mbyllën. Ja, kështu filloj jeta ime...

Oh, mes atyre të burgosurve gjeta njerëz të sojit tim, aty prapa hekurave mendja ime sikur gjeti paqen...

Në këtë botë të madhe rreziku është aq afér kudo, në këtë botë ku secili çapitet për liri për mua rreziku më i madh që në shoqëri.

U kërkova atyre në Institucion të më dërgojnë

por më thanë se ai ishte mbushur i téri, mua s'mund t'më gjendej një vend...

U ulë në gjunjë, iu përgjërova: "Oh, ju lutem më nxirri që këtej", por ata s'donin ta dëgjonin lutjen time dhe asgjë që unë thosha.

Ndodhi në prag të Krishtlindjeve, që një mbrëmje e vitit '59 kur vrava një njeri, nuk u përpoha ta fsheh këtë.

Juria më shpalli fajtor s'kam si t'i ikë këtij dënim, dhe sado që të protestoj a mundem gjë të ndryshoj?

Ndihem mirë që s'i kam prindërit për të më parë si jam katandisur dhe për të derdhur lot për mua, s'do e dinë ç'vdekje e tmerrshme më pret.

Jam i lumtur që as miq s'kam pasur

që tani të turpërohem para tyre, ata s'do ta shohin kurrë kokën time teksa në duart e xhelatit përfundon.

Lamtumirë o pyje veriore brodha aq shumë nëpër ju, lamtumirë mejhane të mbushura që shtëpia e streha ime keni qenë.

Lamtumirë dhe ju o njerëz që sado pak ndjeni dhimbje për mua, disa nga ju edhe do të ndiheni mirë kur të më shihni të varur atje lart.

Kam sall një pyetje para se shpirt të jap, djemtë e tjerë që rrugën time do ta ndjekin a do t'i konsideroni vërtet armiq apo viktima të shoqërisë suaj?

(1962)

Shqipëroi: Bujar Mehollı

POETI

Pasuria e poetit është e barabartë me poezinë e tij
Fuqia e tij është dora e tije majtë
Ajo është përtace e ngadalëtë dhe e vyer
Skamja e tij është pasuria e tij, pasuri që mund ta shkatërrojë atë
si Mida
Sepse ajo përtaci është njëfarë forme e padurimit
Dhe nga kjo ai mund të mund të shkatërron
het nga ari i drithës
që nuk ka qenë kurrë
Në tokë apo në det.
Ai mund të jetë i dehur për vdekje, duke shtetur fuqitë e teprisë
Atë formë ekstreme të sukzesit.
Ai mund të pësojë fatin e Narcisit
I paafët për të jetuar përvëçse me imazhin që është daldi
Dashuri, e verbër, e adhuruar, e

tejmbushur
I paafët për t'iu përgjigjur çdo gjëje që nuk sjell dashuri
shpejt ose menjëherë.

...Poeti duhet të jetë i pafajshëm dhe injorant
Por ai nuk mund të jetë i pafajshëm pasi budallallëku nuk është
pika e tij e fortë
Prandaj Cocteau ka thënë: "Çfarë nuk do të jepja
Të têrhiqen nga ekzistencë poezitë e rinisë sime?
Unë do t'i jepja Satanit shpirtin tim të pavdekshëm."
Kjo metaforë është e gabuar, sepse ishte shpirti i pavdekshëm
që ai dëshironë të shëlbonte,
Duke e ngritur dhe duke e shoshitur atë, të lirë dhe të bardhë,
nga aktualiteti i banalitetit, vulgaritetit të

rinisë,
pompoziteti dhe shtirja e veprave të tij të hershme poetike.

Po ashtu në të njëjtën mënyrë një Poet i Farnshëm amerikan
Kur fama i kishte ardhur më në fund, i kërkonte pesëdhjetë kopjet
e librit të tij të parë me poesi, të cilin e kishte shtypur privatish
me shpenzimet e veta.
Ai arriti të sigurojë 48 nga 50 kopjet, i dogji Dhe pastaj kishte kuptuar se si ekzistuan kan kopjet e fundit,
Siç e kërkonte ligji i vendit, të fshehura në kryeqytet,
në Bibliotekën e Kongresit.
Kështu që, ai shkoi në Uashington, dhe aty i mori dy kopjet e fundit
I futi në xhepin e tij, planifikoi të largohej Ama e ndaluan dhe e arrestuan. Meqenëse ai ishte autori,

Dhe meqë ato ishin librat e tij dhe pronë e tij, e qortuan
Por e falën. Ama dy kopjet ia morën Duke krijuar kështu një precedent kombëtar.

Sepse as amnisti, as falje nuk u jepet poetëve, poezisë dhe vjershavë, Ngase William James, gjeniu i dashur i Harvadit tha të vërtetën tmerruese: "Miqtë e tu mund të harrojnë, Zoti mund të të falë, por qelizat e trurit regjistrojnë
veprimet e tua deri në fund të përjetësisë." Çfarë gjëje e tmerrshme për të thënë!
Kjo është gremisje e pafund, pa kurrfarë ilaci, e poezisë.
Ky është po ashtu edhe gëzimi i përjetshëm i poezisë.

Përktheu: Fadil Bajraj

Pier Paolo PASOLINI

KUJTIME MJERIMI

Për shkak se diçka tjetër po ma han shpirtin:
edhe ky afsh po ashtu mbi të cilën, si tutës që jam,
nuk do të doja të flisja, ky hall tepër i madh dhe për të të ardhur keq për ta shprehur
pafundësinë e thellë dhe të mjerueshmë që ende në vete mban gjithë dhembjen tonë.

Dëshira për të qenë i zoti për të llogaritur bile në bukë, së paku, dhe në një grusht lumturie -
Ama meraku, që është më i dobishmi për të mbijetuar,
Po më ngulfat pa kurrfarë gjallërie...

Sa shumë e kam çuar jetën poshtë, me vite i papunësuar, sa trishtueshëm, viktimi e trullošur e shpresave obsesive. Çfarë jete, për çdo mëngjes më duhej të çaja turmat e uritura nga shtëpia e varfanjakut të humbur në skaj të qytetit deri te shkolla e të mjerëve në një tjetër periferi: punë e pranuar sall nga njeriu që është në pikë të hallit për të cilin çdo formë e jetës është armiqësore.

Ah, autobusi i vjetër i orës së shtatë që ndalej në fund të linjës Rebibbia ndërmjet dy koliveve dhe një rrokaqelli të vogël, qyqevetëm në acar a në pikë të zhegut...

Ato fytyra të kalimtarëve të përditshëm sikur të kishin dalë në shëtitje nga barakat e trisha, plot dinjitet dhe serioz, me gjallëri të shpifur borgjezie duke maskuar frikën e kahmotshme të mjerimit të ndershëm.

I tyre ishte mëngjesi përcollues në fushat e blerta bishtajore të Anienes, ari i ditës kundërmon në plehra të shpurritur, drita shpërhapëse e pastër posi shkëlqim hyjnor mbi vargun e kasollave të rrënuara që koton tashmë në qellin e ngrontë... Ai vrapim i paftymë midis panoramave të ndërtesave të ngushta,

brigjet e shkrumbuara të Tiburtinës... Ata rreshta punëtorësh, të papunësuarish, hajnash, që nisen, ende të lyrshëm me djersë të përhimtë nga shtrëtërit ku kanë fjetur kokë e këmbë bashkë me nipërit në dhomat e vocërra e të pista, të pluhurosura si qerre, të ndotura dhe me kënaqësira... Ato paralagje të qytetit të ndara në ngastra, të njëlljoja, të thara nga dielli i valë në mesin e guroreve të braktisura, pendëve të shkatërruara, kolibeve, fabrikave ku punëtorët shfrytëzohen për të të ardhur keq...

Përktheu: Fadil BAJRAJ

Diamanti që Artur Miler i fali teatrit

THE CRUCIBLE

Ku qëndron thelbë i kësaj vepre, e cila tronditi kaq shumë sistemin shoqëror të kohës dhe vazhdon ta bëjë edhe sot?

Grigor JOVANI

Padyshim, Artur Miler (1915 - 2005), shkrimitari amerikan i teatrit, më i spikaturi i shek. 20-të, ka lënë gjurmë të pashlyeshme në letërsinë e vendit të tij dhe më gjërë, me veprat themës së menduara dhe të realizuara kaq vërtetësisht, saqë duhet të rendim epokave të thella të letërsisë botërore, të gjejmë emrat e dramaturgëve më të shquar, për ta krahasuar. Modernia tek ai ka ardhur natyrshëm, bashkë me kohën, rrjedhës së lumenjve nëntokësorë të artit, që nuk kanë shtuar qysh nga epoka e skenës së artë të antikitetit. Kohën e tij, Artur Miler e përfaqësoi në mënyrën më adekuante, mbasë më mirë se çdo shkrues tjetër i letërsisë. Në teatër, po se po.

Qofsha i tepruar në vlerësimin tim të mësipërm, por veprat tilla të reperitorit milerian, si "The Crucible", nuk të lenë shkas përmes interpretime të tjera. Ky krimi vërtet është një kryevepër, parë kështu jo vetëm në prizmin letrar, për vlerat artistike që mbart, por edhe si një vepër e thellë shoqëroro-politike, për varet mesazhet që transmeton.

"The Crucible", që unë do ta shqipëroja në mënyrë metaforike "honi thithës", u shkrua në një periudhë të vështirë përmes gjatës së shkullit të kaluar, kur ihtarët e McCarthyist kishin filluar "gjuetinë e shtrigave" dhe nën flamurin e antikomunizmit, synonin të shkatërronin çdo gjë progresive në artet amerikane. Mirëpo, madhorja këtu është se ndonëse u shkrua gjatë këtij ballafaqimi dramatik forcash shoqërore, përmes t'i kundërvënë regresit makkarhist në Hollivud dhe në krejt letërsinë bashkëkohore, kjo vepër i kapérceu kufijtë e kohës, duke u bërë një alegori e përgjithshme përmes ndjekjet dhe persekitimet e njerëzve të pafajshëm, në sajë të një sistemi të tërë shpifjesh dhe dëshmish të rreme. Brenda historisë së tij të hershme të dëshmive të rreme dhe të sajaura përmes "mëkatin e magjisë" në Salem - vegël ogurzezë e çdo kohe gjatë së përhershimes "gjueti të shtrigave", Miler eksploroni edhe tema të tjera, atë të pushtetit, të allishverishave ekonomike, të korruptionit, ndërgjegjes shoqërore dhe të histerisë së përgjithshme.

Ku qëndron thelbë i kësaj vepre, e cila tronditi kaq shumë sistemin shoqëror të kohës dhe vazhdon ta bëjë edhe sot? Pika e interesante se zbulohet fakti fatal: interesat e disa grupeve apo kastave politike përmes rruajtur me çdo kusht hegemoninë e tyre, mund të çojnë në atë realitet që po përfjetonte Amerika e viteve 50-të, në shfrytëzimin e sistemit (gjaja) të pavarrur të Drejtësisë përmes shtrëmbëruar të vërtetë. E vërteta bëhet relative dhe manipulimi një mjet i qëllimshëm. Kjo temë është rrënjosur thellë në historinë njerëzore dhe nuk vjetrotet kurrë. Vetë hegemoni përmes kohe janë të interesuar ta kenë gjithmonë në rend të ditës, përmes rastin më të parë që do u nevojitet. Kësisoj, shkrimitarët e mëdhenj shoqërorë si Miler, nuk mund ta heqin kurrë nga radari i tyre krijues. Ngaqë thjesht, arti i tyre madhor ndjek hap pas hapi shoqërinë. Kjo, parë në prizmin më të gjerë të rëndësishëm shoqërore të kësaj vepre. Por s'mund të ishte kaq madhore ojo, pa veçanësitet artistike, letrare dhe dramaturgjike, të cilat e bëjnë kaq të



rëndësishme në botën e letërsisë dhe veçanërisht të teatrit.

KARAKTERE TË THELLË: Karakteret e "The Crucible" janë kompleksë dhe shumëdimensionale. Përplasjet brenda tyre, pasionet dhe dilemat psikologjike ku janë mbërthyer, përbënë brumin e parë përmes spektatorëve i historisë që prekupon vepren në fjalë, kalon nëpërmjet karaktereve që zhvilohen në të, lidhjes ndjeshmëri që shikuesi krijon me çdo personazh.

RRJEDHE E TENSIONUAR: Kemi të bëjmë me dramë. Nuk mund të kuptohet pa ndeshjet e tensionuar, intrigat dhe përbysjet. Subjekti shtjellohet në mënyrë dinamike, gjë që ngjall entuziazëm dhe ankth. Spektatori, me shpirt nepromtuar, pret shpjegimet...

SIMBOLIKE E FORTE: Vepra është e mbushur me simbolizma, që kanë të bëjnë jo vetëm me ngjarjet në Salem, por edhe me probleme më të përgjithshme shoqërore dhe politike. Kjo ngjeshje simbolike i shërben themës së veprës dhe ndihmon zberthimin e shumanshmërisë së kësaj ngjarje dramatike.

MJESHTERI GJUHESORE: Vepra më e punuar, gjë në Hollësira, gjuhësishë e Milerit. Nuk ka neglizhuar askund, nga dialogët gjë tek monologët. Risitë e tij

janë efektive dhe shpesh mbartin kuptime të rrënjosura thellë, që shpalosen teksta historia vazhdon.

TEMA TE DITES: Ndërsa ngjarjet zhvilohen alegorikisht në shek. e 17-të, drama preokupohet prej temash të ditës. Xhanëm, temat në fjalë kanë preokupuar gjithë kohërat. Çështje pushtetesh, korupsioni, shqyrtimi i histerisë së përgjithshme shoqërore - janë tema universale, gjithmonë në rend të ditës. Aq shumë në kohë kur jeton shqerisht edhe Artur Miler.

DILEMA NDERGJEGJEJE: Është drama me më shumë dilema të tilla, jo vetëm në bagazhin krijues të këtij autori të madh, por në gjithë letërsinë amerikane. Të merret fryma nga dendësia me të cilën shpalosen ato para karaktereve dhe spektatorit. Ky eksplorimi i thellë i shpirtit të njeriut, i natyrës njerëzore në përgjithësi, njëkohësisht i fal edhe thellësi dhe shumëkëndshëmëri shikimi kësaj vepre.

ALEGORIA: E thamë ca më lart, drama nuk është thjesht një histori e hershme zhvilluar në Salem, por një alegori e thekshme përmes kohës së pasluftës në Amerikë, kur po ç'demokratizohet dramatikisht jeta shoqërore, me ndjekjet, ekstremizmin e djaththë dhe me korruptionin gjithnjë në rritje. Kjo vlerë alegorike e veprës e bën atë gjithmonë aktuale. Gjithashtu, është një dramë që të bën të mendosh gjatë dhe thellë.

"The Crucible" është një nga diamantët më të çmuar në veprën e Artur Milerit, por në asnjë mënyrë nuk mund të neglizohet pjesa tjetër e krimitarisë. Ka një gamë të pasur vepresh. Ajo që nuk ndryshon është kjo: gjithmonë eksploroni natyrën njerëzore dhe dinamizmin shoqëror. Në më të shumtën ia ka arritur të sjellë diamante më të vegjël, por gjithsesi me shumë vlera. "Vdekja e një shitësi" shqyrton ambicjet, dilemat shpirtërore të njeriut dhe marrëdhëniet brenda familjes, kurse drama "Pas rënies" thullohet në introspeksion dhe shpall pyetje rreth përgjegjshmërisë dhe fajit.

Lamë përmes fundit të kujtojmë se Artur Miler ishte përmës kohë bashkëshorti i njërit prej yjeve më të ndritshëm të Hollivudit, aktore Marilyn Monroe. Kjo lidhje natyrshëm ngjalli interesim më të madh nga publiku përmes veprës së Milerit. Aftësia e tij e jashtëzakonshme përmes krijuar histori botërore, të cilat pasqyrojnë forcën dhe pamundësitë e gjenit njerëzor, e ngre në piedestalin e njërit prej shkrimitarëve më të mirë teatrorë të shek. 20-të, me mesazhe të gjithkohshme.

(Athinë, gusht 2023)

GJON MILI - FOTOGRAFI I SHQUAR SHQIPTARO-AMERIKAN

Më 15 shkurt 1984, në Stamford (Konektikat, SHBA), ndahej ngajeta prej pneumonisë, në gjendje të rënduar psikike, por me "mbjellje" madhore në fotografi, shqiptaro-amerikan i shquar, Gjon Mili, ai që fotografoi si askush tjetër "vizatimet me dritë"



Nga Qerim VRIONI

Gjon (i pagëzuar Jani) Mili u lind në Korçë (ndoshta në fshatin Progrë) më 28 nëntor 1904, nga dy prindërit korçarë. Familja "Çekani" e të emrës ishte mjafë e njohur në krahinë. Një paraardhës i saj, Konstantin Çekani përmendet si iluminist në Akademinë e Voskopojës. Kur mbushi pesë vjeç, familja e Gjonit shkon në Rumania (Bukuresht), ku e priste i ati, Vasil Mili. Fillimi i jetës rumune për Janin e vogël ishte i vështirë, sapo kish mësuar mirë shqipen, tani i duhej të mësonte dhe rumanishten. Gjithsesi, nis shkolimin të cilin e përfundon në Gjimnazin e njohur "George Lazaru" të kryeqytetit me nota shumë të mira (1923). Pak muaj më vonë, udhëton drejt SHBA, me ftesë të ungjitet, Koço, për të vazhduar atje studimet e larta. Me të mbritur në Boston, regjistrohet në Institutin Teknologjik të Masaçusetsit, ndër më të njohurit në botë, për inxhinier elektrik ndriçimi e, mbas katër vjetësh studimi, ai diplomohet. Menjëherë fillon punën në korporatën e madhe elektrike "Uestinghauz". Ndërkohë, Jani forcon lidhjet me shqiptarët e hershëm të Bostonit, duke u bërë veprimtar i gjallë i Shoqërisë "Vatra", ku u zgjodh edhe në kryesinë e degës së qytetit. Madje për disa kohë punon edhe si redaktor në organin e saj, gazeten "Dielli". Kësaj kohe i përket edhe njohja e Janit me eruditin e shquar, Faik Konicën, i cili e nxiti inxhinierin e ri shqiptar t'i drejtështë edhe arteve, kryesisht kinematografisë që ishte tanimë në zhvillim të vrullshëm. Në Boston, Jani, si zakonisht të huajt, e kish amerikanizuar emrin në John (Xhon), por kjo zgjati deri më 1927, kur me sugjerimin e Konicës, vendosi t'a shkruaj fare shqip, Gjon. Në këtë vit e hasim për herë të fundit emrin John në një foto të "vatranëve" me Konicën më 1927. Këshillën "prindërore" të letrarit të mprehtë, Gjoni e zbatoi duke i kushtuar kinemasë që në atë kohë ishte pa zë. Ndërkohë ai kishte mësuar shumë mirë dy gjuhë, shqipen dhe anglishten. Madje ai shkruan në gjuhën armtare, dy novelat të shkurtra me tema shqiptare, të botuara në "Dielli" (1928) e, më pas edhe në revistën "Studenti shqiptar" (1929) që nxirri Odise Paskali në Torino të Italisë. Ato, dallohen përgjithës pastër dhe të pasur shqipe.

Ai kishte filluar të ndiqte me endje të veçantë kinemanë, duke i shikuar filmat disa herë madje edhe i përpunonte sipas fantazisë së tij, në të njejtën kohë, merrej si amator edhe me fotografi. Në krye të dhjetë viteve punë si inxhinier elektrik ndriçimi, më 1937, Mili takohet me prof. Harold Exherton (Edgerton, 1908-1988), shpikësin e flashit elektronik (drita stroboskopike) me të cilin fotografohej gjatë nëndarjeve shumë të holla të sekondës, që e tërhoqi mjaft shqiptarin. Atij filloi t'i punoj me shpejtësi fantazia dhe menjëherë vendosi të linte punën në "Uestinghauz" dhe t'i përkushtohej përfundimisht vetëm fotografisë.

Kështu, takimet me dy njerëz, Faik Konicën, i cili e drejtoi t'u kushtohej arteve dhe me Harold Exhertonin, që i dha dritën stroboskopike, përbëjnë dy momentet kyse të jetës së Gjon Mili, pa të cilat, ndoshta nuk do kishte "lindur" ky fotografi i madh. Pas realizimit të disa fotove interesante me

flashin elektronik, Mili nisi të punoj si fotograf për revistën e ilustruar amerikane "Life", e cila botej prej dy vitesh. Në të njejtën kohë, ai falë edhe profesionit të inxhinierit, bashkëpunon ngusht me prof. Exherton. Madje, ky e vlerëson tepër Milin duke e quajtur "vizonar" dhe duke shtuar se "ai na udhëhoqi", megjithatë, më pak seç meritonte. Fillon të fotografoj shumë e subjekte të ndryshëm, sport, muzikë, këngëtarë, kërcimtarë, piktorë, por gjithnjë në kërkim të risive në formë dhe përmbytje, duke krijuar mjaft fotografi të veçanta. Kështu, më 1942, fotografon daljen e një predhe nga gryka e armës me shpejtësi një të miliontë e sekondës, shtypi e quajti "shpikja e shekullit". Një vit më pas realizon foton shumë të njohur "Lindy Hop", me kërcimtarët Leon James dhe Willa Mae Ricker, foto e cila "përfaqëson" shpesh herë Milin në botime të ndryshme. Po më 1943, Mili filloj të organizojë në studion e tij të "Rugës 23" të Nju Jorkut, të famshmet "Jammin's session". Ato ishin takime artistësh dhe njerëzish të kulturës, si poetë, këngëtarë, kërcimtarë, instrumentistë etj. që shpalosnin aty krijimtarinë e tyre, gjatë tyre zhvilloheshin madje dhe diskutime estetizante. Në to merrnin pjesë figura me emër të kohës si Duke Ellington, Billy Hollidej, Lester Jung, Gene Krupa etj. Niveli i lartë i bisedave mbi artin dhe kulturën në studion e Mili, bëri që fotografi i madh francez, Henri Cartier-Bresson, ta quante atë, "Athina e Nju Jorkut".

Pikaso duke vizatuar me drite

Më 1944, Mili i kthehet "dashurisë së vjetër platonike", kinemasë. Ai me guxim e besim ne vete, realizon një film të shkurtër dokumentar mbi muzikë jazz. Filmi i cili zgjat 10 minuta, quhet "Jammin's the blues", ai eshtë vlerësuar përférherë nga kritika saqë vazhdon të shfaqet edhe kohëve të fundit në festivalin kinematografik ndërkombëtar të muzikës jazz. Në të ndihet dora e sigurt dhe fantazia pjellore fotografit, i cili edhe pse vetëm prej 7 vjetësh merrej me të, krijoj një film, ku shumica e sekuencave përbëjnë foto mjaft të arrira. Në suksesin e filmit të Mili, ndikoi dashuria e tij përmuzikën jazz si dhe, njohja e muzikës në përgjithësi, ai ekzekutonte si amator me instrumentin e obosë. Ky film tregon edhe se Mili ishte pa paragjykime racore, të gjithë aktorët ishin me ngjyrë. Dhe kjo në vitin e largët 1944.

Fotografi të Mili, ndërkohë pëndoreshin edhe si ballina të revistës "Life", e cila në ato kohë arriti tirazhin më të madh, rreth 8 milion kopje. Emri i tij po bëhej kësosoj i njohur në mbarë botën. Kështu, ekspositën e tij të hapur në Paris në vjeshtë 1946, e përuroi me fjalë të ngrënës filozofin i njohur francez, Zhan Pol Sartre. Në Paris, po atë vit, ai ndërmjet shumë fotove, realizon edhe atë të këngëtares simbol, Edit Piaf, duke kënduar, që përbën një nga fotot më të goditura të tij me procesin e grafikimit. Duke mbetur tek portretet, shënojmë se Mili ka fotografuar mjaft figura të njohura të kohës nga shumë fusha si presidenti Truman dhe ministri Molotov, piktorët Picasso, Brak, Matis, kompozitorin Stravinski, muzikantë si Duk Ellington, Pablo Kazals, Frank Sinatra, Zhylljet Greko, Edit Piaf, shkrimitarë si Shon O'Kejsi etj, por në historinë botërore të fotografisë ai nuk përmendet si fotoportretist. Mendoj se ndoshta, përsjashim këtu eshtë vetëm fotoportreti i fundit i Shon O'Kejsit (1964). Megjithatë, fotoja "Pikaso duke vizatuar me dritë" (1949), përbën një portret fotografik të një natyre tjetër. Ajo mund të quhet një fotoportret i kompozuar. E menduar mirë na duket përfshirja e saj në kapitullin "Portraits-a World of people" (Portrete-bota e njerëzve) të botimit "LIFE-The Classic Collection, Në York, 2008", dalë në qarkullim në dhjetor të vitit

të shkuar. Pjesë e tij eshtë dhe fotoja tjetër e Mili, "Lindy Hop", e cila bashkë me "Pikaso" futen në 100 fotot më të mira të revistës "Life" përgjatë 60 vjetëve të saj. Këto foto, sugjeroohen nga përpiluesit e tij, si të përshtatshme për t'u vendosur në banesa apo zyra. Shtojmë këtu se fotoja "Pikaso" duke vizatuar me dritë" (b/z) përfshihet në albumin "The Photo Book" (1999), me 500 fotografat më të zgjedhura nga e gjithë bota. Shënojmë këtu, se në një sondazh nga revista amerikane "Popular Photography" (1959) për dhjetë fotografët bashkëkohor më të mirë në botë, ndërt fituesit renditej dhe Mili, krahas Kartje-Breson, Alfred Aizenshted (Eisenstaedt), Jusuf Karsh, Ricard Avedon, Ansel Adams etj. Votuan gjithsej 243 kritikë arti, botues, mësues, fotograf, kuratorë etj.

Fotografitë e shumta që i bëri Mili, piktorit Picasso, por edhe punëve të tij të pikturë dhe skulpturë, jo vetëm ngjizën miqësinë e gjatë të tyre, por "e detyruan" fotografin t'i përmblodhi ato, më 1970, në albumin "Picasso's - The Third Dimension" (Përmësia e tretë e Pikasos). Në të ai shpërfraq edhe disa parime interesante vetjake mbi estetikën e arteve pamore. Risi në zbatimin e procesit të stroboskopisë, "copëzimit të lëvizjes", Mili, shpërfraqi në mjaft foto me temë nga kërcimi, muzika e sporti. Veçohën këtu, fotoja "Nudo duke zbritur shkallët" (1942) dhe "Pas de Bourree" (1947). E para përbën një trajtim "par exelencë" i të njëjtë subjekt pikturuar nga modernisti francez, Marsel Dysham më 1912, por tashmë me gjuhën dhe mjetet e fotografisë. Kjo eshtë nga fotot që e përfaqëson më shpesh Milin në botimet e ndryshme për fotografinë, ndërsa, e dyta, një pattern i gjetur sinusoidal, ishte një nga pesë fotot me të cilat ai u paraqit në Eksposicion e Madhe "Familja e njeriut" (1955). Ndërkohë, ai, si fotoreporter me kontratë i "Life" (asnjeherë s'ka qenë në stafin e revistës), viziton vendë të tjera dhe fotografon njerëz, ngjarje, por edhe arkeologji, skulpturë, pikturë, histori etj. Në vitin 1966, Mili i ndodhi një fatkeqësi e pariparueshme, djegja e studios së tij të famshme e "Rugës 23", ku u shkrumbuan me mijëra foto, dhurata si dhe korespondencia e vyer me qig, ndër to edhe ajo me Picasso. Kjo e hidhëroi pa masë, ndonëse një pjesë e filmave ishin të dubluar në arkivin e revistës.

Nudo duke zbritur

Vlen të përmenden se më 1971, Festivali i përdyjetshëm i fotografisë në Arle të Francës, iu kushtua veprimitarës së Gjon Mili, vlerësim i ndjeshëm, por i merituar. Po atë vit, ai kërkoi vizë në ambasadën shqiptare në Paris për të vizituar vendin e "rrënjeve" të tij, gjë që iu refuzua prerë dhe ftotë nga përfaqësuesit e diktaturës, kjo e pezmatoi thelli. Në të njëjtin vit, Mili viziton Rumaninë me të cilën e lidhë fëmijërija e ku kishte dhe të afërm. Duke mos u ndarë përfundimisht nga "Life", Mili ndjek si fotoreporter, Gjyqin e famshëm të skandalit të Uttergejtit, më 1973, ku realizon mjaft fotografi të goditura, ku vërehet fare mirë gjendja psikologjike e pjesëmarrësve. Në vitin 1980, Shqipëria e Grafistëve të Nju Jorkut, bota albumin-monografi, "Gjon Mili-Photographs&Recollections", shtypur në Boston. Tekstet dhe fotot janë shkruar e përzgjedhur nga vet Mili. Ky botim, deri tanë, përbën përmbledhjen më të plotë të kërijimtarisë së tij. Prej vitit 1998, MIT (Instituti Teknologjik i Masaçusetsit) organizon Konkursin e fotografisë "Mili&Edgerton" për studentët, si nderim të dy ish-studentëve të shquar të tij. Emri i Gjon Mili, falë fotografive të tij plot fantazi dhe risi, eshtë bërë mjaft i njohur në botën e fotografisë. Ai përmendet në disa libra për fotografinë (rreth 30 syresh ka shfletuar shkruesi i këtyre

radhëve), por edhe në revista të specializuara të vendeve të ndryshme. Fondi më i madh i fotove të Mili ndodhet në MOMA (Nju Jork), ku disa janë edhe të eksponuara. Në vendlindje emri i Mili filloj të përfillet vetëm pas 1991, me ardhjen e demokracisë. Kështu, atij iu akordua titulli i lartë, "Artist i Popullit" (pas vdekjes) nga Presidenti i Republikës, Sali Berisha me dekretin Nr.373 datë 27.11.1992. Ky titull nderon jo vetëm atë, por edhe "binjakët" e tij në Shqipëri, si të barabartë me një emër që ka njohje në botë, çka bashkëkombësit e tij në atdhe, përmotivë të ndryshme, fatkeqësisht nuk e gjëzojnë. Po reshtojmë më poshtë pjesë nga disa vlerësimë për Gjon Mili, të shkëputura nga botimi dhe periodikë të shumtë. Dennis Stock (1928), fotograf, ish-nxënës i Mili për katër vjet, shkruan për të: "Mësova gjerat thëlbësore të të bërit të eses dhe disiplinës fotografike kur punova si ndihmës pranë fotografit të revistës "LIFE", Gjon Mili. Ai kërkonte shumë, por ishte dhe bujar". Susan Kismaric, studiuase e fotografisë në MOMA (Muzeu i Arteve Moderne, Nju Jork), e cila ka qenë ndihmës e Mili, në vite thotë: "Gjon Mili ishte tërheqës dhe gjithë mister, i gjatë, i moshuar dhe hijerëndë. Zëri i tij i trashë dhe me theks ishte i jashtëzakonshëm dhe sugjessiv. Përshtypja ime nga John Swarkovski (ish-drejtë i MOMA) ishte se ai mendonte se Gjon Mili, kishte mendje të madhe dhe, që ndoshta, ai ishte më shumë një mendimtar se sa fotograf". Kompozitor i madh, Igor Stravinski, në një letër e përmend Milin duke thënë: "...portretin tim të mrekullueshëm me ngjyra nga Gjon Mili". Filozofi i njohur francez, Zhan Pol Sartër mendonte se e njihet më Milin dhe artin e tij dhe, nga ç'ka shkruar për të, jepim vetëm fjalinë: "Për atë ka një pafundësi mënyrash të fotografuar, siç eshtë pafundësia e gjera që na rrethojnë". Martine Franck (1935-2006), fotografë franceze, bashkëshorte e Kartje-Breso, e cila ka punuar pranë Mili në Paris, shprehet: "Punova për të (Milin-shënim) im) një seri fotosh që bëri ai për ndikimin e Romës së lashtë në Francën e Jugut. Ato nuk ishin thjeshtë shkrepje. Çdo gjë ishte ndriçuar dhe kompozuar shumë bukur". Shpkësia i drithës stroboskopike, Harold Exherton, ve në dukje për Milin: "Ai njohur forcën e drithës stroboskopike, që e përfshinë me një rreth me 1000 fotografi". Kompozitor i madh, Igor Stravinski, në një letër e përmend Milin duke thënë: "...portretin tim të mrekullueshëm me ngjyra nga Gjon Mili". Filozofi i njohur francez, Zhan Pol Sartër mendonte se e njihet më Milin dhe artin e tij dhe, nga ç'ka shkruar për të, jepim vetëm fjalinë: "Për atë ka një pafundësi mënyrash të fotografuar, siç eshtë pafundësia e gjera që na rrethojnë". Martine Franck (1935-2006), fotografë franceze, bashkëshorte e Kartje-Breso, e cila ka punuar pranë Mili në Paris, shprehet: "Punova për të (Milin-shënim) im) një seri fotosh që bëri ai për ndikimin e Romës së lashtë në Francën e Jugut. Ato nuk ishin thjeshtë shkrepje. Çdo gjë ishte ndriçuar dhe kompozuar shumë bukur". Shpkësia i drithës stroboskopike, Harold Exherton, ve në dukje për Milin: "Ai njohur forcën e drithës stroboskopike, që e përfshinë me një rreth me 1000 fotografi". Kompozitor i madh, Igor Stravinski, në një letër e përmend Milin duke thënë: "...portretin tim të mrekullueshëm me ngjyra nga Gjon Mili". Filozofi i njohur francez, Zhan Pol Sartër mendonte se e njihet më Milin dhe artin e tij dhe, nga ç'ka shkruar për të, jepim vetëm fjalinë: "Për atë ka një pafundësi mënyrash të fotografuar, siç eshtë pafundësia e gjera që na rrethojnë". Martine Franck (1935-2006), fotografë franceze, bashkëshorte e Kartje-Breso, e cila ka punuar pranë Mili në Paris, shprehet: "Punova për të (Milin-shënim) im) një seri fotosh që bëri ai për ndikimin e Romës së lashtë në Francën e Jugut. Ato nuk ishin thjeshtë shkrepje. Çdo gjë ishte ndriçuar dhe kompozuar shumë bukur". Shpkësia i drithës stroboskopike, Harold Exherton, ve në dukje për Milin: "Ai njohur forcën e drithës stroboskopike, që e përfshinë me një rreth me 1000 fotografi". Kompozitor i madh, Igor Stravinski, në një letër e përmend Milin duke thënë: "...portretin tim të mrekullueshëm me ngjyra nga Gjon Mili". Filozofi i njohur francez, Zhan Pol Sartër mendonte se e njihet më Milin dhe artin e tij dhe, nga ç'ka shkruar për të, jepim vetëm fjalinë: "Për atë ka një pafundësi mënyrash të fotografuar, siç eshtë pafundësia e gjera që na rrethojnë". Martine Franck (1935-2006), fotografë franceze, bashkëshorte e Kartje-Breso, e cila ka punuar pranë Mili në Paris, shprehet: "Punova për të (Milin-shënim) im) një seri fotosh që bëri ai për ndikimin e Romës së lashtë në Francën e Jugut. Ato nuk ishin thjeshtë shkrepje. Çdo gjë ishte ndriçuar dhe kompozuar shumë bukur". Shpkësia i drithës stroboskopike, Harold Exherton, ve në dukje për Milin: "Ai njohur forcën e drithës stroboskopike, që e përfshinë me një rreth me 1000 fotografi". Kompozitor i madh, Igor Stravinski, në një letër e përmend Milin duke thënë: "...portretin tim të mrekullueshëm me ngjyra nga Gjon Mili". Filozofi i njohur francez, Zhan Pol Sartër mendonte se e njihet më Milin dhe artin e tij dhe, nga ç'ka shkruar për të, jepim vetëm fjalinë: "Për atë ka një pafundësi mënyrash të fotografuar, siç eshtë pafundësia e gjera që na rrethojnë". Martine Franck (1935-2006), fotografë franceze, bashkëshorte e Kartje-Breso, e cila ka punuar pranë Mili në Paris, shprehet: "Punova për të (Milin-shënim) im) një seri fotosh që bëri ai për ndikimin e Romës së lashtë në Francën e Jugut. Ato nuk ishin thjeshtë shkrepje. Çdo gjë ishte ndriçuar dhe kompozuar shumë bukur". Shpkësia i drithës stroboskopike, Harold Exherton, ve në dukje për Milin: "Ai njohur forcën e drithës stroboskopike, që e përfshinë me një rreth me 1000 fotografi". Kompozitor i madh, Igor Stravinski, në një letër e përmend Milin duke thënë: "...portretin tim të mrekullueshëm me ngjyra nga Gjon Mili". Filozofi i njohur francez, Zhan Pol Sartër mendonte se e njihet më Milin dhe artin e tij dhe, nga ç'ka shkruar për të, jepim vetëm fjalinë: "Për atë ka një pafundësi mënyrash të fotografuar, siç eshtë pafundësia e gjera që na

NUMRI I ARDHSHËM MË 5 TETOR

HEJZA

20 SHTATOR, 2023

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**
Drejtor: **Genc Halimi** (genc@takat.tv)

Rruga e Kaçanikut nr. 208, Shkup, 1000